

BIBLIOTEKA

E

8JH - 1

SHTETITI

S. 57

GJIROKASTER

Shihgr

TUR  
EMRA  
LET

8JH 21  
S. 57

891. 883 - 1.

DRAGO SILIQI

# KUR ZEMRA FLET

(Vjersha dhe poema)

14701  
52835



## PARATHËNJE

Në një fletore të poetit me kapakë bojë kafe të errët, fletore fort e çmueshme për ne, me dorëshkrime provash, vjershash, poemash, deri te poema e fundit, që mbetet dhe vepra e tij madhore dhe një nga ma të randësishmet e poezisë sonë të re të realizmit socialist, «Këngë e re për dashurinë e vjetër», fletore ku kemi mendime interesante dhe plane krijuese, na lexojmë edhe një shënim mbi ndonjë vjershë që, si duket, dë-shironte t'ja kushtonte udhëheqësit të rinisë dhe poetit Qemal Stafa. «Njizet e dy ti ishe, — shënoi ai. — Njizet e dy ti mbetesh gjithmonë. Dhe brezat që do vijnë do thonë Qemali 20-vjeçar». Edhe vetë Dragoja, që mbeti për ne përjetësish 33-vjeçar, ashtu si gjithë shkrimtarët dhe artistët tanë, shkon drejt rrugës së revolucionit populor, i gjallë, i qeshun, me «Zemrën që flet».

Dragoja leu më 9 qershor 1930 dhe u rrit në një familje këpucari e poeti me shumë fëmijë e me shumë halle. Ma vonë i vdiq e ama, të cilën ai do ta përmendë me mallëngjim fisnik në vjershat e veta. 14-vjeçar ky «bir i vojtjes», që kishte një dashuni të madhe për njerëzit e për atdheun, doli malit partizan dhe, mbas cli-

rimit, 17-vjeçar, më 1947, u pranue në radhët e Partisë sonë heroike. Prej vitit 1949 ai ishte anëtar i Komitetit Qendror të BRPSH. Jeta e tij qe e shkurtër, por e dendun, e mbushun plot me punë e përpjekje. Në vitet 1946-1951 punoi në shtypin e rinisë e të pionierëve. Ai qe një entuziast i punës me talentet e reja në organin «Letrari i ri». Në vitet 1952-1957 ndoqi e kreua në Moskë studimet e larta letrare. Kurse vitet 1957-1958, si korrespondent për Shkodrën i «Zërit të Popullit», i vleftejn shumë për t'u thellue në njohjen e jetës. «Gishtin t'i vëmë pulsit të kohës, veshin t'i vëmë zemrës së dheut», shkruen ai në fletoren e vet, tue pasë parasysh nevojën e krijimit të një poezie të vërtetë, të thellë. Dhe, në një vend tjeter, shënon: «Si duhet të jesh i partisë», tue nën vizue me këtë idenë themelore se, që të jesh poet, duhet të jesh i partisë. Në vitet e fundit të jetës 1959-1963 ai zhvilloi një veprimitari me të vërtetë të frytshme si poet (më 1960 batoi poemën «Këngë e re për dashurinë e vjetër») dhe si përkthyes, si kritik, veprimitari, e cila është përfshirë në vëllimin «Në kërkim të së resë» dhe si drejtues i aftë e i pasionuem i Shtëpisë botuese «Naim Frashëri».

Në krye të dorëshkrimit të një poeme poeti pat vizatue një yll me pesë cepa, kurse, në fletoren e tij, na lexojmë këto fjalë kushtue Marksit: «ikën e u zhdukën qindra sundimtarë, . . . por ti, me mjekër por si borë, qëndron i pavdekshëm». Dhe në një faqe tjeter, tue meditue mbi figurën e Leninit, ai shënon: «. . . Por ka njerëz të atillë q'u falet zemra. Leninit

*i gjithë njerëzimi ja fali zemrën». Dashunia dhe urrejtja vlojnë në mendimet e poetit, dashunia për popullin, për komunizmin, urrejtja për shtypjen dhe shfrytëzimin. Ai shfren kundër imperialistëve: «Nga agonia në çmenduri po kalon kapitali». Në fletore na vëmë re këto fjalë të përzemërtat drejtue atdheut: «E unë me ty u mësova, atdhe; kudo që të shkoj, në luftë po të jem duke vdekun, mendimet e mia do të jenë drejtue nga ti». Ma tej në fletore ai thekson: «Mue kaq poet më duket vetja» dhe shton në kllapa: «sido mos atëherë kur kujtoj... dorën e babait këpuçar, bukën që s'na mjaftonte në shtëpi». «Isha trembëdhjetë, — shënon ai, — kur fillova të mendoj përse jetoj». Dhe në moshën 14-vjeçare ai e zgjodhi rrugën e vet të jetës, doli partizan. Në dy fragmente, të shënueme në fletoren e përmendun, ai rrëfen se si provoi për herë të parë ndjenjën e madhe të solidaritetit njerëzor, se si u pushtue nga romantika e luftës për çlirim:*

Ne flnim në mullarë  
me mauzerin krahëqafë  
edhe me dor'n e shokut, që na zgjonte  
kur gati për marshim bahej kolona.

Nuk hanim katër ditë  
Dhe s'vdisnim nga uria.  
Një ftue e ndanim  
në njëzet e pesë copë të barabarta.

*Dragon e bani poet vuejtja e popullit, dashunia për njerëzit e për atdheun e robnuem, idetë marksiste-leniniste të Partisë sonë, që i priu popullit në luftën vigane çlirimtare, lufta revolucionare në të cilën ai mori pjesë aktive.*

*Në një vjershë të pranverës së vitit 1945, «Arratisja e bilbilit», poeti 15-vjeçar përkufizoi për herë të parë kredon e tij:*

S'do të qes ma zane t'buta  
për blerimet që rrrethojnë,  
por tashti do t'kndojo për huta  
që në male fishkullojnë.

Dhe ma tej ai pohon :

do t'këndojo për partizanin  
e për yllin me shqiponjë.

*Kurse në vjershën e fundit të jetës së tij, shkrue në verën e vitit 1963, mendimi i poetit u përqëndrue te ideja e përhershme mbizotnuese e revolucionit:*

Revolucioni — dinamit që hap  
minierat-ar të shpirtit njerëzor,  
rrjedhin pastaj të kaltërtta burimet,  
të pastërtta dëborë;

rreze e fuqishme djeg e përvëlon  
tumoret në ndërgjegje të tulitur,  
ndërgjegjen bën të çelë lule shumë  
si toka e vaditur.

*Ylli i komunizmit, revolucioni, Shqipnia — ja*  
kredoja e poetit në jetë e në poezi. Mendimet e shkë-  
putuna, që disa herë janë gati të ritmueme dhe të  
ngjajnë embrion vjershash të ardhshme, ashtu si edhe  
e gjithë krijimtaria e tij poetike, janë shprehje e botës  
së pasun shpirtnore të poetit, që, tue dalë partizan  
ende fëmijë, vuni përjetë në ballë yllin me pesë cepa  
dhe nguliti thellë në zemër përgjithmonë emnin e at-  
dheut. Ai mbeti një partizan i përhershëm i komuniz-  
mit, një ushtar i vendosun e besnik i atdheut, i Par-  
tisë sonë të lavdishme.

«Sa i ri e sa zemërak ti më thue», polemizon ai në  
shënimet e fletores së tij. Ai pyet: «Po si, si quall, si  
mish pa kocka?», dhe përgjigjet: «Ne kemi formën to-  
në që na dha revolucioni». Atë e shqetësonte mend-  
mi se «sa do t'i kushtonte një minutë planit të shtetit». Ai e ku-  
ptonte se lufta revolucionare nuk asht një gja  
e lehtë. «As ne, komunistët, nënvizonte në fletore, —  
shpirtin s'e kemi shesh». Ai kërkonte njerëz të zjarr-  
të dhe godiste njerëzit pa pasione, indiferentë: «Dhe  
sot ka ndërmjet nesh të ftohtë si peshku».

Tue mendue mbi rolin kryesor të poetit, ai shë-  
nonte se «të shkruesh vetëm vjersha dashunie — si të  
punosh vetëm për qershitë». «Poezia duhet të jetë e

*shumëngjyrshme» theksonte në një faqe tjetër të fletoreve.*

*Drago Siliqi luftonte për një art të denjë për kohën tonë të madhe, për një art me ide të mëdha, me mendime të thella dhe me një formë sa ma të përsosun. Vargu i tij ishte i disiplinuem dhe synonte të ishte sa ma konçiz. Nga krijimet që na ka lanë shihet qartë se tradita e shëndoshë e poezisë shqipe dhe folklori ynë ishin për të mbështetje të sigurta. Ai vetë si poet përpiquej t'i shmangej retorizmit dhe ta pasuonnte poezinë e tij me material të pasun jetësor, luftonte që poezia të hynte sa ma thellë në psikologjinë njerëzore.*

Nguli këmbët mirë te ky dhe  
që të fluturosh në pambarim.

(«Meditime për raketën»)

*Ai nuk ngutej në botimin e librave të vet. Nga një vjershë e marsit 1945 na marrim vesh se kish pregatitë një vëllim me titullin «Këngët e qlliritimit». Por, edhe ma vonë, më 1954 kur pregeti vëllimin poetik me titullin «Të val' e Drinit», ai prapë nuk shpejtoi. Vëllimi mbeti i pabotuem. Prej tij na kemi zgjedhë për këtë përbledhje punimet ma me vlerë. Ai ishte dhe bahej përherë e ma kërkues. Me poemën «Këngë e re për dashurinë e vjetër» ai nisi një periudhë ma të ngritun të krijimtarisë së tij poetike, që dëshmonte*

tashma për pjekurinë poetike, për eksperiencën ma të gjanë e ma të asimilueme të jetës, për preqitjen e tij të gjithanshme ideore dhe artistike. Ai u nda prej nesh në këtë fazë të randësishme të krijimtarisë dhe të jetës. Por me jetën dhe veprën e tij mbeti përgjithnjë midis nësh, midis popullit, me mendimet dhe ndjejnjat e tij fisnike, revolucionare, me poezinë e tij, me atë thirrjen e zjarrtë, programatike, për të jetue në kohën tonë të lavdishme, për të njohë thellë zemrën e popullit tonë heroik: «gishtin t'i vemë pulsit të kohës, veshin t'i vemë zemrës së dheut».

Pjesën ma të zgjedhun të asaj që poeti na la ju do ta gjeni në këtë vëllim. Por shumë dëshira e plane ai mbeti pa i realizue. Tue shfletue me kujdes fletoren e tij të shënimave dhe dorëshkrimeve si dhe tue u mbështetë në dëshmi të atyne që e njohën për së afërmë, ne marrim vesh mjaft prej planeve të tij.

Poitet i ngrihej para syve e kaluemja heroike e popullit tonë, trimat që luftonin kundër robnisë turke, nën udhëheqjen e Dedë Gjo' Lulit, për të ngulë flamurin në Deçiq. Ndër strofat e veçanta, që na kanë mbetë, na lexojmë për Franin dhe për një çikë malësore:

.... N'shkamb të Hotit  
ajo dilte shpesh për me kundrue  
se si çuhej tymi i barotit  
në Deçiq, e rrinte tue mendue...

Përmbi shpinë buljerën ajo mbante,  
që luftarve me gurmaz të thamë  
t'mund t'u shuente etjen, bukë t'u ndante,  
dhe t'i hidhte Franit nji të pamë...

*Dhe pastaj malësoren trime poeti na e përshkruen të vrame.*

Interesat poetike të Drago Siliqit ishin të gjana. Ai shënonë në fletore: «Asimi ynë vdiq në Spanjë». Si duket, kish ndër mend të shkruente ndonjë vjershë apo poemë kushtue luftëtarëve shqiptarë të Spanjës.

Në një faqe lexojmë shënimin: «Lufton çeta, s'kish fshati bukë)... (Të korren arat kur korrin plumbat)... Kajani... Gureza (fshati)». Ndoshta poetit i ngucte fantazinë figura e Kajo Karafilit?

*Dhe gjejmë, andej-këndej, disa herë edhe me ndonjë shënim plotësues, një radhë tituj vjershash e poemash, që mbetën pa u shkrue:* «Kasnecja (e para herë kasnece vasha)»; *Kur më ra Lenini në provim»;* «Kanga (Ku ka tre shqiptarë ka kangi). Kanga për jetën, kanga për vdekjen)»; *«Me djalin prej Panariti»;* «Mësues unë doja t'isha»; *«Poemë për marinarin tonë»;* *«Dasma... (kur u martue ai nji ditë vetëm pat pushim...)»;* *«Alpinisti (në majën ma të naltë)»;* *«Andrra e Marës»;* *«Povjesti në vjershë për fëmijët... (Feriti... sot kapiten... Jeta e rrugaçëve, etj.)»;* *«Vargje mbi mjeshtëri poetike»;* *«Ti ma i ndershmi duhet të jesh, poet».*

*Biografia e shkurtën, por e pasun e poetit, gjeti pasqyrimin e vet edhe në botën e tij poetike, që ai me ndërgjegje e këmbëngulje po e pasunonte çdo vit e ma shumë.*

*Gjithë jetën e tij pra poeti ja kushtoi atdheut, komunizmit, artit tonë të ri të realizmit socialist. Ai vdiq shumë i ri, por «ai jeton, — siç pat shkrue me plot të drejtë shkrimtari Shevqet Musaraj në ato ditë të korrikut 1963, — në ëndrrat dhe në mendimet e shokëve të tij, të frysëzuar po nga ato ideale të mëdha të sionalizmit dhe të komunizmit, që ngritnë birin e mjerimit, Drago Siliqin, në shkallën e poetit luftëtar të popullit të tij».*

**Llazar Siliqi**



Partizan në batalionin Krujë-Ishëm, maj 1944 Drago Siliqi  
14 vjet, i gjashati nga e majta.

## **REVOLUCIONI**

Revolucioni — një marshim i gjatë.  
Revolucioni — ecje e vështirë.  
Ai duhet të kalojë mbi greminat,  
                          mbi maletërrëpirë.

Anijes aq vigane n'u傑 thellë  
tinës aisbergët shpesh i qasen pranë,  
por syri i shqipes i heton dhe anija  
                          i shmang ose i çan.

Revolucioni — dinamit që hap  
minierat-ar të **shpirtit** njerëzor,  
rrjedhin pastaj të kaltëra burimet,  
                          të pastëra dëborë;

rreze e fuqishme djeg e përvëlon  
tumorët në ndërgjegje të tulitur,  
ndërgjegjen bën të çelë lule shumë  
                          si toka e vaditur.

## **USHTARI YT DO JEM PËRHERA**

E zbetë ishtejetaime,  
si bir i vojtjes, varfanjak;  
fëmi i mjerë, prak më prak,  
më ngrysej dita në mjerime.

Duart e mijaprejfëmije  
nuk kishin ngjyrë prejdëbore, —  
të zeza, të ashpra, plot me kore,  
me mëngët grisur varfërie.

E ardhmjaime ish si nata,  
ku s'dukej rrugë dhe ndriçim.  
Në gji të hidhur, pa shpëtim,  
më pristejeta me mandata.

Po rrugës sime ti më dole  
si yll i drithës, i lirisë,  
parti, o nënë e vegjëlisë,  
së pari mua kur më fole.

«Urrejtjen, — ti më the, — ta ngresh,  
ta ndezësh zemërën me zjarr,  
ta çosh lart grushtin përmbi varr,  
që skllav pér jetë tē mos flesh!»

Pa zerin tēnd tē së vërtetës  
ç'do isha unë, kushedi?!  
Skllav i përbuzur pa çati,  
i humbur n'udhërat e jetës.

Ti ma ke dhënë jetën mua,  
ti nëna ime je, Parti.  
Mësim'n e parë më dhe ti:  
kë tē urej dhe kë tē dua.

I ashpér ti më ke mësuar  
tē jem me ata që gjithëmonë  
na kanë thithur gjakun tonë;  
kundër armiqve tē tërbuar.

Me dashuri tē pakufi  
më ke gatuar zemrën time  
pr' ata që u rritën në mundime,  
pér punëtorë, vegjeli.

Dhe më të fshehtat t'i tregoj,  
Parti, o nënë heroinë.  
N'orët e mia më kritike  
gjithmonë zërin ta dëgjoj.

Si drita je për sytë e mi,  
për jetën time je pranvera.  
Ushtari yt do jem pérhera,  
un' të betohem, o Parti!

1951



Janar 1963 Kubë.

## FLAMURI I PARTISË

*Kangë*

— Ju ngrihi, të shtypun! — thërriti Partia.  
— Shkelmoni zinxhirët, të ndyrën skllavni!  
Në ju qëndron fati, në ju asht fuqia,  
ja vdekje — liri!

Në male, në fusha kushtimi ushtoi,  
u ndez porsi zjarri krahnori i vegjlisë  
kur lart u shpalos e përpara valoi  
Flamuri i Partisë!

Me qindra, me mijra të shtypun u ngritën.  
E nisën betejat. Kudo fitimtarë!  
Dhe bijtë e Partisë si yje shëndritën  
mbi qiellin shqiptar...

Ja, bie Qemali me flamur në dorë  
dhe flet i gjakosun, me plagët në gji:

— Ne jetën e falim, ne biem dëshmorë  
për ty, o Parti!

Mbi tankës hidhet Vojua, mahnitet anmiku!  
Dhe fjal't e heroit i ndien gjithë Shqipnia:  
— S'e mposht komunistin as zjarri, çelniku.  
të rrojë Partia!

... Beteja n'beteja kaloi fitimtar  
dhe dritën dhe jetën i dha vegjëlisë.  
Në t'ardhmen e ndritun na prin si fanar  
Flamuri i Partisë!

1948

## **ATDHEU**

Kudo që fati të tē çojë  
me mijë vërste larg shtëpisë,  
në zemër ndjen tē tē randojë  
një ndjenjë si plumbi mu në sisë;

tē tē randojë ndjen një dëshirë,  
një peshë e randë, një copëz dhe,  
që tē mban lidhë në hapësirë  
me dhenë e vendit ku ke le.

Atdheun nuk e ndjejshe fare  
kur je përditë në gji tē tij.  
S'të kap ty etja mundimtare,  
kur ke burimin pranë dhe pi.

Deti, çdo orë që e vështron,  
përshtypje s't'ban, me tē je rritë;  
se ke nevojë nuk e kupton  
për thellësinë e tij çdo ditë.

Malet e nalta deri në re  
të duken mure të shtëpisë  
dhe s'i ven re ti naltësisë,  
pa t'cilën dot nuk rron mbi dhe.

Kupa e qiellit — kaltërsi  
çati të duket, dhe s'e ndjen  
se pa këtë ajër — pastërti  
të zihet fryma, gjoksi t'zjen.

Dhe ai varr nën atë dulli  
n'pikllimin tand kaq shumë a shkri,  
sa ti s'e di, sa ti s'e di  
se ç'forcë magneti ka ai.

Atdheun nuk e ndjejshe fare  
kur je përditë në gji të tij,  
s'të kap ty etja mundimtare  
kur ke burimin pranë dhe pi.

**1953**

## **REPUBLIKËS**

*(Kangë)*

Për shekuj kto brigje dhe male kunorë  
buçiten nga lufta e shenjt' për liri.  
Me gjak, Republikë, me mijra dëshmorë  
n'beteja ta shkruen ty ligjin e ri.

Shqipni, o atdhe shqiponjash të lira,  
të mbrojmë në shqota me zemrat barot.  
Lulzo, Republikë, që kpute zinxhirat,  
lulzo si pranvera, ke popullin sot.

Miqsi që nuk thyhet, puntorë e fshatarë,  
ne lidhëm për jetë në zjarr për çlirim.  
Partia e dashun kalit luftëtarë  
të armës kreshnike në luftë e ndërtim.

Agimet e reja të kthjellta si qielli  
shkëlqejnë plot jetë kudo sot në atdhe.  
Me popujt véllezën përpara, se dielli  
përhera na ngroh, ndrit rrugët për ne!

## **SI MOLLA TË EGRA JEMI RRITE**

Rritun si molla të egra të malsisë,  
në acar të egër — erë e borë e ngricë,  
ne ecim n'jetë me ritmin e stuhisë,  
mbi dhe si molla të egra jemi rritë.

Por ngrica dot për tokë s'na rrëzoi,  
as si gorica mali ne s'u thamë.  
Revolucioni erdh e na shartoi,  
të bukur formë kurmit tonë i dhamë.

**1956**

## NJË ULLI NË BREG TË JONIT

Në breg t'Himarës, Jonit përkundrueli,  
ku thonë se asht mbretnia e bukurisë,  
një trung i vjetër ngrihet posa kullë  
si shumë të tjerë në brigjet e Shqipnisë.

Si kullë e vjetër, por n'lulzim për jetë,  
dymijë vjet ma parë rranjë ai ka zanë  
e dymijë herë pranverat ka pëershndetë,  
ka lidhun kokrra, gjeth të rij ka dhanë.

Sa bashkëkohës iu banë shkrumb e hi!  
Nga të gjithë shokët ai ma larg shkoi!  
Sa shkuen e erdhën njerëz n'gjithësi,  
ai si lidhs i shekujve qëndroi.

Kur në këtë breg e mbolli krejt të njomë  
fidan'n e tij iliri për kiamet,  
s'e muer me mend se n'Republikën tonë  
do të jetonte n'shekullin njëzet!

Po t'kishte gojë ky dru njëmijvjeçar,  
do t'ish ai ma i miri historian.

Kaloi romaku i egër e barbar  
këndej, kaloi vampiri otoman.

Ta presën deshën drurin e florijtë  
e brigjet deshën me ja lanun shkret.  
Porse shqiptarët — buqit dhe barijtë —  
u çuen me cfurqe,  
n'kambë ullini mbet!

Ai për shqiptarët bukë e dytë qe.  
Sa pleq ktu erdhën, mblodhën për fëmijë  
kokrra, nga era që binin përdhe.  
Dhjet' vjet ma parë, thonë, nën hije të tij

një muej të tanë jetuen dy partizanë  
veç me ullij e me një thrime bukë...  
Der n'ditët tonë deg't e tij plot janë.  
Legjendë dikuj kjo mundet me iu dukë...

Por n'breg t'Himarës, Jonit përkundruell,  
për t'mijtën vjetë fletët shushurit  
ullini i vjetër, ngrihet posa kullë  
e kokrra t'reja jep ai për çdo vit.

Në pamjen tandem, pemë legjendare,  
kullë e motnueme po për jetë n'lulzim,  
unë shoh fytyrën e tokës shqiptare,  
unë shoh fytyrën  
e popullit tim.

**1955**

## **SA FORT, SHQIPNI . . .**

Sa fort, Shqipni, sot faqen ndrrue ma paske,  
m'i nxirrke basmet me maqina vetë!  
E shih anmiku shqipen edhe plaske...  
Ju lumshin krahët, o punëtorë duerletë!

Sa mirë sheqerin nga panxhari e nxirrke  
dhe kilovatet — nga e lumi valë!  
Të ardhmen e bukur, o Shqipni, ç'ma tirke!  
Të lumshin duert, o popull i pandalë!

**1953**

## KUR PYESJA NANEN

Pse nuk ka tavan shtëpia jonë?  
Pyesja nanën time unë sa herë,  
kur pikonte shiu natën vonë.  
Por çka mund të thonte ajo e mjerë?

Dhe dallndyshat, gjegjej, krahë kur s'kanë,  
çerdhen s'munden ende me ndërtue.  
Kur t'më rriti ju të fortë, azganë,  
shtëpinë tonë do nisim na me çue.

S'e kuptonte ajo se s'ish fuqia  
që vendoste, por padrejtësia.  
Kur të rriti, thonte, e sigurt jam,  
do të kemi shtëpi me tavan.

Pse një herë në muaj vec bajmë laknor?  
Pyesja nanën time, kur me mue  
ajo dilte me një trajse në dorë  
në ara gjeth hardhie me kërkue.



Maj 1963 gjatë vizitës në Kinë.

Kush ka shumë fëmijë, o bir, kshtu rrон.  
Se çdo gojë don bukë, çdo trup këmishë.  
Zani i saj më dukej se ankon  
për barrën e randë — një turre fëmijshe.

Unë mendojshia: Shtatë fëmijë? Po, shumë.  
I merrsha me radhë, bijsha n'mendime:  
Po mos t'ish ai, ajo, o unë...  
Jo, secili vend kish n'zemër time!

Nanën time e pyesja unë shpeshherë  
për çdo gja, kur apo hyjsha n'botë;  
për lulet që çelnin në pranverë  
dhe për dhitë që shkonin me kullotë.

Ajo qejfin nuk ma prishte kurrë.  
Zemra e saj për mue ishte si gurre.  
Qysh në djep m'këndonte mue përhëra:  
«Ti m'u rritsh, o bir, me njëqind shqerra».

Si shqiponja veten rrezikonte  
zogjtë e saj nga ydekja t'i shpëtonte.  
S'ishte ndjenja e saj dhe aq e drejtë,  
por e bardhë si bora dhe e shejtë.

Nuk u rrita unë me njëqind shqerra,  
si m'këndonte ajo mue përhëra;

por u rrita n'krah me mauzerin,  
fyt pér fyt e sy pér sy me tmerrin;

\* \* \*

Po të ishte gjallë ajo këtë ditë,  
ndofta zemra prap kish me i ngri  
nga gëzimi duke pa fëmitë.  
Por do vdiste t'paktën n'lumtuni.

Do na mblidhje ajo posa kaçakët,  
si dikur, të shtatë nën një jorgan.  
Dhe, megjithse burra sot, mustakët  
s'do na i shihte. N'dhomën me tavan

do na rrokte si fëmi papra  
kaqe vjet nga malli përvëluem.  
Dhe laknorin kishte me na e nda,  
si dikur, njësoj... por mue ma shumë.

Dhe njëherë ma shumë gëzim do kish  
kur të shihte se çati i vumë  
gjithë atdheut, q'arna-arna ish,  
dhe kasolleth varfanjake mbluem...

**1956**

## NANA

Ashtu si lulet t'kujtojnë maj  
dhe shiu qiellin mbushë me re —  
të duket sikur emni i saj  
të ban me dijtë se ke atdhe...

\* \* \*

Ate ti ndofta e ke kalue,  
ma i madh se ajo je ba me shtat,  
ma shumë ti vende ke shikue,  
ajo për jetë ka ndejë në fshat;

por floku i saj, ku ka ra bora,  
çdo rrudhë e ballit t'saj tregon:  
ma shumë ka pa e i ka prekë dora,  
ma mirë e njeh këtë dhe ku rron.

Udhheqës qofsh a shkencëtar —  
përpara saj ti je fëmi.

Ajo asht pylli drithmtar,  
ti një nga drujt që ka në gji.

N'se i ngjan liqenitjeta e saj  
herë me tallaze e herë e qetë,  
ti s'je veçse një valë — fiskajë.  
që n'gji të tij amshon për jetë.

E bardhë asht zemra e saj si borë,  
që shkrin, bahet burim, freski.  
Dhe zani yt sado burrnor  
**asaj i duket si kërthi...**

**1953**

## MOTRËS

Të takova sot mbas katër vjetësh,  
larg të kam kujtue kaq muej e stina.  
Sot u bane ti shtatëmbëdhjetësh,  
paske hedhun shtat si mandarina.

Sa të vogla duerët ti m'i kishe  
kur shkumbzonin rrobet në govatë.  
Porsi nanë e vogël pér ne ishe,  
mbyllshe sytë e lodhun pér çdo natë.

Ma e vogla qe ti në shtëpi,  
bukë e djathë ma pak mirrshe nga krejt,  
dhe kur vllau mbetej pa u ngi  
pjesën tande ti ja falshe shpejt.

Katër vleznit ishim si kaçakët,  
pér të sotmen rronim na pérherë.

Pasunia kishte jetë të pakët —  
rrobet, paret, buka bahej erë...

Vetëm ti tek ne ishe si bleta,  
që e mbledh nektarin qosh më qosh;  
që të blije fjongun për gërshtet  
një vit rrjesht ti ruejshe soldë e grosh.

Sytë e tu at'herë shihnin përdhe  
po të thonte kush se je e bukur.  
Nën fanellë tashti një ndjenjë të re  
ndjen dhe krahë të jepka porsi flutur.

1956

## **PRRONI**

Përpara ktij prroni kalojsha pérherë  
unë qysh se kur isha fëmi.

Këtu edhe çojsha pranverë edhe verë,  
me not unë i bijsha atij.

Me kangët e tij u msova kaq fort —  
me mue edhe shokët barij —  
me peshqit e vegjël që zejsha me shportë,  
me gurët, që vritsha gjarpij;

sa doja të rrija aty unë për jetë,  
por ja se ne fati na ndau,  
dhe sot, pranë tij njëzet e pesë vjet,  
mue prroni i hershëm më pau.

Unë shumë kam ndryshue dhe vitet  
që shkuen  
mbi flokët e mi kanë lënë gjurmë,

por prroni ka mbetun, thue, i viteve të parë,  
të njajtat thue valë edhe zhurmë.

Më duket tashti ai kaq vocrrak,  
s'më vjen mue as deri në bres.  
Por ecën ai dhe s'ma var mue aspak  
dhe drizat i çan mes për mes. . .

Kujtoj unë sot andrrat që pata dikur  
pranë tij me jetue e punue...  
dhe them: si më mbante mue shpresa  
n'krahnuer  
për jetë me ndejë te ky prruje?

Ndoj punë shumë e madhe atij s'i përket  
si Drinit, si Matit, të thuesh,  
dy-tre kilometra i shket a s'i shket,  
me lumin bashkohet në fushë.

Ai këtë e di mirë, por vite të tanë  
çan rrugën me plot krenari  
dhe ndjehet i lumtun që n'detin e gjanë  
do shkojnë disa pikë të tij...

**1955**

## BARESHA

Përvëlonte kudo zhegu,  
Mara rrinte mu te bregu,  
kur nga larg po vinte begu:  
— Vash'o, ç'ke që rrin aty,  
— Vash'o ç'ke që s'sheh me sy?

S'lacente vasha. Frynte erë.  
kurmi i saj porsi mermer!  
U hodh kali si me tmer  
kur tha vasha mu në breg:  
— Unë bariun pres, o beg!

**1956**

## PRANVERA ERDHI, PO S'LULZOI

Pranvera erdhi, po s'lulzoi,  
burimi çurkat i lëshoi  
si lote atë ditë.

Dhe dallëndyshja në çati  
kangës ja tha me ngashëri —  
i dukej ditë pa dritë.

Thërriste dega e qershisë,  
e kumbullës dhe e kajsisë —  
u thanë ato fort heret!  
Kokrrat e tyne, si kusarë,  
si faqezij e tahmaqarë,  
ja vodhën bersalierët!

Këndonte mbreti si kokosh  
dhe thosh se ishte shumë trimosh,  
por iku shpejt si pulë.  
Vetëm ky popull luejti gisht,

mallkoi mbret edhe fashist.  
s'duroi me u përkulë!

U ngritën furka dhe sqeparë  
kudo në malet shqipëtarë  
më shtatë prill atherë.  
Nuk çelën kumbull e qershi  
dhe nisën jetën në stuhi —  
për t'pasë gjithmonë pranverë!

1956

## **PLAGA**

I thjeshtë ish sa s'bahet dot  
spitali i vogël partizan.  
S'kish salla t'ndrituna si sot  
e as ilaçe për derman.

Ish në spital doktor i parë  
vajza, që s'kish pesëmbëdhjetë.  
Gjethet e dushkut ishin bar  
dhe fash' për plagë këmisha vetë.

N'sa çelnin malet në pranverë  
dhe ndiente zogjt' tue cicërue,  
sikur i ftonte ajo pérherë  
ata në shpellë për me këndue.

Kur ujë unë dojsha me sy hupë  
nga dhimbja e plagës (s'kishte gotë),  
dy duert e veta i bante kupë,  
me pi më jepte mue atbotë.

Të freskët unë në mend e mbaj  
kur si fëmisé m'epfte qershi.

Dhe m'dukeshin mue duert e saj  
porsi dy degë plot bujari.

Shumë ditë me plagë në kashtë i shtri  
qiellin s'e pashë unë dot n'atë shpellë.  
Por para meje — kaltërsi  
kisha dy sytë e saj të thellë...

Që atëherë shumë vjet kaluen,  
plaga — kaloi edhe ajo...  
Plagë të reja u shënuen, —  
u zhdukn' e u mbyllën dhe ato...

Por ata sy unë s'mundem dot  
me i harrue. I shoh përsri...  
Dhe them me vete unë dhe sot:  
mos vallë kjo ishte dashuni?!

**1955**

## MBI ROZAFËN SHEKULLORE

Shkodra ish kala e fundit. Kishin mbetun dhe pak orë për anmikun e kapitun orë e mbrame që të bjerë. Ecnin—ecnin partizanët përmbi male me dëborë nëpër net me suferinë pa u ndalun kurrnjëherë.

Buna rridhte madhështore pranë qytetit heroik, ku për mote, ku për shekuj s'u shue zjarri për liri, bijve trima partizanë, që në zemër kanë çelik, sikur valët u këndonin me gëzim e brohori:

— Drejt veriut, pa u ndalun, ecni trima partizanë! Ndër kasollet vorfënore, që janë mbytun në mjerim, dritë e jetë të mjeruemve ju u çoni anembanë, se qyteti, se Rozafa po ju presin pa durim! —

Dhe një ditë të Nandorit, një ditë vjeshte në agim, që nga Vjosa në Bujanë hodhi dielli rreze jete, shqipja trime, madhështore, nalt u çue fluturim dhe kaloi përmbi male, fusha, fshatra dhe qytete.

Dha sinjalin e hareshëm përmbi vdekjen e tiranit,  
se atje n'kalanë e fundit, mbi Rozafën shekullore,  
u zhduk nata përgjithmonë, ndriti ylli i partizanit,  
u ngrit flamur' i lirisë me lavdi e me fitore.

1948

## **HELMËSI**

Krenar ndër këto male asht populli, që iroi  
në shekuj i pamposhtun. S'asht lehtë t'i përshkosh  
kta shkrepë të thepisun. Por partizani shkoi  
n'çdo skutë edhe çlironjës, me ta u përshëndosh.

Ja Helmësi ku shtrihet qyteti i rinisë,  
n'majë mali, ku shqiponja e lirë fluturon.  
Dhjetë vjet ma parë buçiti ktu kanga e djalërisë,  
jehona e saj krenare ktu ende sot jeton.

Ja pyjet rrëth e rrotull, — shtëpi ishin ahere,  
ku rronin delegatët e flinin me gjerdanë.  
Burimi në mes fushës, që dha freski pranvere  
mbi buzën e zhuritun të shokve partizanë.

Çdo pllambë e ksaj lugine luftarët të kujton  
dhe histori të gjata ty mundet të t'rrëfejë...  
Ja Nako me Enverin ku rri e bisedon,  
ja Xhelo ku hedh valle, n'sa mendja i rri n'betejë.

Dhjetë vjet kaluen. Ku janë sot shokët që këtu qenë?  
Të ndryshme rrugët ishin dhe fati i shokvet tonë,  
disa n'beteja ranë dhe kurrë ma s'u ngrenë,  
lavdia por të gjithve u rri mbi kokë gjithmonë.

Dhjetë vjet kaluen. Nga zjarret, që ndizeshin ktu  
natën,  
s'ka mbetur sot as gjurma nga erë e borë e shi.  
Dhjetë vjet kaluen. Po zjarret q'u ndeshën me  
shtërgatën  
kudo sot dritë japid, o shokë, mbi Shqipni.

**1954**

## LIGJ I RI MBI MAT

Mati për shekuj këndoi  
një kangë të ashpër rebele.  
Dhuratë ai detit i çoi  
shpeshherë kasolle e zabele.

Kur dimnit, i demun nga bora,  
zemrohej në nete stuhie,  
me vdekjen shoqnohej dhe fora  
ja behte mbi ara e kopshtie;

dhe bukën ai zallit ja falte.  
Fshatari përtipej zorrthatë,  
kalimin ndër rruga e ndalte.  
— M'ep udhë — thosh plaku i ngratë.

Por s'ndiente, jo, vala rebele,  
përgjigjej me gjamë e llahtar,

fshatarin e veshun me zhele  
e merrte me plaçkë e gomar.

Të shohësh në hartën e tija:  
nga desh ka çà rrugë i tërbue.  
Por Matin sot puntoria  
ligjit të vet ja ka shtrue.

Dy brigjet, që shekuj jetuen  
si vllezën të ndamë e pa nanë,  
për herë të parë u bashkuen  
dhe dorën si miq e kanë dhanë.

1954

## MËSOVA ATË DITË...

I etur unë erdha këtu në malsi,  
që Matin e egër të shoh,  
kasollet e vorfna si rrojnë në veri,  
dhe jet'n e puntorve të njoh.

M'habiti muejeta e malsorëve tonë,  
që ende mbajnë drunin nën krye  
dhe fjalë ankimi nuk dinë të të thonë,  
nuk dinë me u lodhë e me u thye.

Vorfnia, si ferrë që na mbiu kudo,  
nuk pritet me kosë menjëherë;  
dhe vneshta, kur mbillet, të rritet kohë do,  
pastaj të jep rrush edhe verë.

Instinkti më shtyn dhe kravatën e heq  
dhe mangët mbi brryl i përvesh.  
Bloknoti s'më duhet, — të vejë në dreq! —  
turistin ktujeta e përqesh.

Dy ditë e dy net pa gjumë i kanë gdhi  
për t'ngritun digën n'afat;  
për t'dhanë dekoratat janë mbledhun tashti,  
për t'çue në Kongres delegat.

Sa shumë që kanë ecë punëtorët, mendoj,  
me zemër të bardhë si dëborë,  
po dhe egoizmin në vete hetoj,  
ndër ne, që mbajmë pendën në dorë.

Mësova atë ditë sa për vjete të tanë  
çka n'kokë unë e kisha si re:

S'don ara uratë, por don shatë,  
puntori e fshatari janë forca, që mban  
Shqipninë mbi kurriz e jo ne.

**1954**

## PESHKATARËT

Këthehet barka nga peshkimi,  
deti dremit me valët harg,  
në horizont skuq perëndimi  
posi njëmijë flamurë varg.

Janë atë e bir, që çuen sot ditën  
me rrjeta n'dorë, shpërvjelun mangë,  
që në mes dallgëve bukën qitën,  
dy breza janë, këndoijnë një kangë.

Janë brez mbas brezi lundërtarë,  
valët i kanë si truell të shpisë,  
erën kanë motër të pandarë,  
yllin polar si busull-pris.

Sot s'u ngrys ftyra si njëherë —  
tregtari i «hakut» n'breg s'i pret,  
q'u merrte peshkun dhe si vlerë  
dy kile miell u jepte shkret.

1956



Qershori 1963 në Kore

## TE VALA E DRINIT

### I

Si flutra t'bardha lehtas shkund era  
lulet e blinit.

Në festë asht veshun sot nga pranvera  
lugina e Drinit.

Pranverë e freskët posi burbuqe,  
lulzo gjithmonë!  
Pranverë e bardhë, pranverë e kuqe  
si flamujt' tonë!

Te shpati shtrihet e bardhë borë  
shtëpia e Gjinit.  
Asht rrit ai brigjesh me krrabë në dorë  
te vala e Drinit...

## II

Ai lexonte i mendueshëm.  
Ndjenjat i vlonin në krahnor,  
përpara tij sa i mrekullueshëm  
prendimi i diellit pranveror!

Me dhitë krejt ditën sot e çoi,  
përshkoi malin në sheti.  
E diela bukur i kaloi,  
nesër -- në shkollë përsëri.

Vëllau i vogël pranë i rrinte,  
ja ndiqte rreshtat në lexim;  
në sytë e dlirë thellë i ndrinte  
dëshira Gjergjit për mësim.

Blegërijnë dhentë. Edhe traktori  
nuk ndihet ma nëpër luginë.  
Me dhitë përpara **Gjini** mori  
nga shtopia rrugën mbi rrafshinë.

Para një drize, si me u ndeshë  
ndër ujq, dhitë shtangën! Kur një za:  
— Or meca, **ndalni!** — Gjinit n'veshë  
si fishkull gjarpëni i ra...

### III

Muzgu i mbramjes u end  
si pëljurë më çdo anë.  
Pionieri Gjin Kola  
fill u ndal me të vllanë.

Dhe nga driza e murme,  
nga ku doli ushtima,  
sytë drejtoi. Nëpër gjeth  
kishin dalë dy kaptina...

Iu afroen fëmijve  
pak nga pak si dy hije.  
Zani i qeshun na ish,  
por i shplamë e pa shije.

Për familje dhe fshat  
shumë e pyetën ata.  
Na u shtinë si miq  
q'aty rruga u ka râ.

Dhe djaloshit i dhanë  
vetëm një porosi:  
Ndue Veselin me thirrë —  
miq kanë qenë në ushtri,

Por Gjin Kola pionier,  
nxan's i klasës së shtatë,  
e vështroi me dyshim  
në fytyrën e thatë...

Ndue Veseli, mendoi,  
s'ish i pastër në fshat...  
Italia kur erdh —  
coi shtëpi me dy kat,

Gjini solli ndër mend  
fjal't e gjyshit në varr...  
— Miqt' me bukë e me krypë,  
e anmikun me zjarr! —

Mori vllaun e dhitë,  
edhe shtegut përpjetë...  
Sikur t'kish mundësi  
t'i kish kambët me fletë!

#### IV

Më kot dy miqt' Veselin pritën  
të hanin darkën në katund.  
N'mbarim të natës, pa zanë ditën,  
për mik u gjendën tjetërkund.

Kur panë lakun t'u shtrëngohet  
në fyt si dana, duert i çuen.  
Lart qelli nisi të zbardhohet  
dhe yjtë e fundit lehtë u shuen...

U nis djaloshi Gjin at'here  
me libra n'dorë si për çdo ditë,  
n'luginë po frynte erë pranvere  
fytyrën lehtas tue i flladitë.

Herë kthente kokën nga shtëpia,  
ku i ati pendën kishte lshue.  
Mendonte: ndoshta gjithë malcia  
mbramë pushkët tona ka dëgjue...

N'Tiranë te Enveri ndoshta mbrrinte  
sot lajmi i fshatit guximtar.  
Gjithë natën s'fjet. Por syni i ndrinte.  
e ndjente veten si ushtar.

1953

## **LAHUTA**

Bashkë me pushkën shok të pat për jetë  
ty malësori ynë, moj lahutë.

Ky teli yt — poet i lindun vetë —  
din të këndojoë egër edhe butë,

Siç di shqiptari hasmit m'iu kërcnue  
dhe t'i buzëqeshë mikut në shtëpi,  
hallet e gjimet nëpër telat tu  
posi nga zemra dalin nji nga nji.

Ti malet tona kaqë mirë i njeh,  
si era pyjet. Ato ushtimë të kanë.  
Si kanga jonë ti të ardhmen sheh,  
kur do të ketë diell apo tufan.

Harrove vajet ti ka disa vjetë  
dhe për gëzime vetëm ja ke marrë

atje ku çifti hapin ven në jetë,  
ku ndër shkambije hapet rruga e parë.

Bashkë me pushkën shok të pat gjithmonë  
shqiptari, që çoi jetën me rrufe.  
Ti, kang't e t'parve ja jep brezit tonë  
dhe brezit të ardhshëm —  
**kangën** tonë të re.

**1955**

## RRANJËT

Deri n'nanddhjetë e nandë s'e la fuqia  
dhe kopshtin mihte vetë dhe krrabën vetë  
e priste nëpër shqopa. Kurrë stuhia  
s'ja krrusi shpinën deri në t'qindtë vjetë.

Tash shtri te shtrati mjekërderdhun borë  
ditët e fundit ai kalon nën diell,  
posi një dushk ai duket shekullor  
rrëzue nga koha, por me rranjë të thellë...

Do të lulzojnë ato rranjë përsri  
mbi tokë kushdi dhe sa qind vjeta tjerë.  
Ai një nip ushtar e ka n'ku fi  
dhe një te fshati traktorist me nder.

Fuqi gjymtyrët atij ma s'i kanë.  
Veç dy tipare jete ka edhe:  
dy sytë e zez prap si të shqipes janë  
dhe buzëqeshja e tij asht prap e re.

1955

## THETHI

Maqinë ndër shekuj s'njohën, as qytet,  
thethjanët egër jetën e kanë çue;  
thue n'fis jetuen der n'shekullin njizet,  
porse liria n'zemr' i kish pushtue.

S'iu nënshtren ata zotit pér hatër,  
as papës e as mbretit me bajrak.  
Me lule e pritën por n'dyzet e katër  
Brigadën tonë edhe flamurin gjak!

Pér të parën herë vajzën jashtë e dhane,  
me fshate tjera lidhn' ata krushqi.  
Zakone t'reja lindën ndër thethjanë  
e ndër shtëpia lindën fmijë të ri.

Sa shpejt që Thethi pamjen e ndërroi,  
në elektrik nga pisha u hodh ai!  
Nga rendi i fisit fshati Theth kaloi  
në socializëm —  
ndrrim që s'ngjet n'kimi!

## SHTËPIA E RE

N'shtëpi të re festoi dhendurinë.  
N'oborr i hodhi valle i gjithë fshati.  
N'mëngjez të ditës nesërme kur u gdhinë,  
s'ndjeu trishtim në zemër si i ati:

se u shtue një gojë, një vrimë e re n'çati,  
dhe tashti ara s'do japë bukë tre muej;  
e s'kaluen javë ma shumë se dy a tri,  
u nis të linte kockat n'vend të huej.

Dhe lidhja e tyne mbeti si kujtim  
i hidhun q'u varorsi lumtuninë.  
Që nga miniera e largët në mërgim  
conte ca grosh për t'birin a të binë...

... E ndjeu i biri veten kaq gazmor  
n'mëngjez të ditës nesërme ku u gdhinë,



Takim me Go Mo Zho, Presidenti i Federatës së Artistëve  
dhe Shkrimitarëve Kinezë.

sa lumtuninë s'e mbante në krahnor,  
sa andërroi të birin a të binë...

Dhe sa pranvera erdhi e çeli maji,  
n'oborr zunë karafilat t'kundérmonin.  
Në dhomë t'lehonës lehtas u ndi vaji,  
por nga ky vaj njerzit n'shtëpi gëzonin.

Kështu tek ne u ba tash ligj n'malsi:  
në vend t'kurbanit, q'duhej ba dikur  
që t'mund qëndronte guri përmbi gur,  
duhet një jetë e re të lindë n'atë shpi!

**1957**

## MIRDITORJA

Atje mbi breg, ku bijnë rrezet e diellit  
e frys puhia e malit letë e letë.  
Shega sykaltërt, porsi kupa e qiekkit,  
del në mëngjez si lule plot me jetë.

E kangën nis ajo porsi bilbil,  
i lumtunisë në gji i ndizet afshi.  
Me një shami të kuqe trandafil  
ajo ka lidhun flokët si mëndafshi.

Balli gjasim asaj i ka me hanat,  
që ndrisin netve t'kthjellëta verore.  
E mirë, e bukur, ka përveshun llanat,  
si kanë zakonin vajzat malësore.

Kanga e jetës i gufon n'krahnuer,  
i jep lulzim si lulevet në maj,  
si armë kreshnike hijshëm i rrin n'duer  
kazma e mprefët, ndrisin sytë e saj.

Atje mbi breg ajo nis me punue  
dhe e ngul kazmën thellë e thellë në dhe.  
Që nga Mirdita ka ardhë me ndërtue  
me duert e saja Hekurudhn' e re.

... T'lartat kujtime hera-herë i qas,  
kur ish shërbtore në shtëpi t'skëterrës.  
n'kullë t'bajraktarit, ku, porsi n'kafas,  
kurrë nuk i shifte lulet e pranverës.

Si ish atje, e myllun, larg s'vërtetës,  
i pshëritinte zemra e molisun.  
Dhe sot ajo faqët e librit t'jetës  
për t'parën herë me i lexue ka nisun.

## NË SYTË E TU

Në sytë e tu nuk ka tufan  
thojsja dikur.

E kisha zemrën si kallkan  
për ty n'krahnuer.

S'më ndizej gjini dot që ty  
me t'pasë në jetë.

Unë dojsha zemër edhe sy  
jo aq të qetë.

Po kur ti çave terrn' e lashtë,  
kur le shtëpi,  
s'u trembe se dyshek me kashtë  
të pret n'Veri;

kur fatit t'dhanë s'i bane bisht,  
(i ashpër t'jetë!)  
dhe s'vune ti unazë në gisht  
qetsi me gjetë;

në sytë e tu unë oqean  
pashë atëherë.

Dhe m'u dukjeta në tufan  
si në pranverë.

E ktheva zemrën unë në zjarr  
për ata sy.

Dëshira m'lindi: deri n'varr  
të jem me ty!

**1953**

## LULES QË MBIN NËN BORË

*Të gjithë më thonë i ftohtë jam,  
S'e dinë se zjarr unë kam në gji.*

Lulzon ti dimnit në tufan  
përmbi lëndinë,  
dëbor'n e ftohtë sipër mban  
edhe nuk ngrin.

Të gjitha lulet duen pranverë  
e ngrohtësi,  
Veç ti n'të ftohtë çel, pérherë  
kërkon veri.

Ti zjarr ke borën, mu nën borë,  
aty zen jetë;  
edhe në akullin dimnor  
ti gjen të nxetë.

Lulzim i heshtun, që bulon  
në mbrendësi...  
Me dashuninë sa fort gjason  
që kem' në gji...

**1954**

## DASHUNIA

Ç'asht dashunia? — flasin shumë në botë.  
Ca lule vjeshte, që gënjejnë rininë.  
Ç'asht dashunia?.. Veç një andrr' e kotë, —  
thonë gjithë ata, që s'njohën dashuninë.

Ç'asht dashunia?.. Interes n'dy anë.  
E krahasojnë ate me tregëtinë  
të gjithë ata, që rini n'zemër s'kanë  
e s'mund ta gjejnë në jetë kurre dashuninë.

Ç'asht dashunia?.. Lule e vërtetë,  
por plaketjeta, ajo ma nuk ndrin, —  
thonë gjithë ata, që s'jetojnë dot një jetë  
e s'kanë fuqinë ta mbajnë dashuninë.

Asht dashunia: krue i pashterim!  
Sa herë që pi, ma shumë të shtohet eti.  
N'te pasqyrohet qelli në kthjellim,  
ma e pafundshme ajo asht se deti.

Asht dashunia: erë e lirë, që fryn  
e plagët ma të randa t'i shëron,  
minierë e thellë, që plot visare ndrym,  
pallat prallor, ku lumtunia rron.

I ka ajo dy sytë porsi perria,  
zemrën e saja ma të nxeh të se zjarri,  
flokët — të arta, ndjenjat — si magjia,  
me te ndër lufta bie luftëtarit.

Edhe nuk vdes. S'asht andërr kjo. E vërtetë.  
Për gjithë ata që kanë dashuni.  
Ajo provohet veç një herë në jetë,  
nuk vdes, as plaket kurrë si pér çudi.

**1953**

## ASAJ QE I NGJAN ANDRRËS SIME

Që në rininë e parë kam andërrue  
për vajzën që do kisha unë dikur.

Më merrte shpesh një mall i pashpjegue  
e zemrën qetë s'e ndjejsha në krahnuer.

Jo shumë e qartë ishte kjo andrra ime,  
ma fort i ngjante erës që barit,  
kronit të vogël, pyllit me blerime,  
pranverës plot me ngjyra, që mahnit.

Por ma e qarta vijë ish, që në jetë  
vajzën ta kisha shok në vështirsi.  
Në mos të bukur, thjeshtësia vetë  
t'ja hijeshonte ftyrën si dhunti.

Kaloj koha, Andërrat rinore  
në një fytyrë të vetme m'u shndrruen mue

Unë s'e harroj kurrë ditën pranverore  
kur sytë e mi panë të dy sytë e tu...

Na rrinin para: librat, shkolla, puna,  
përpjekje dhe mundime plot në udhë.  
Por ma e lehtë tash para nesh furtuna  
e jetës dukej. Ndjenim ma shumë vrull.

Ti çdo minutë tashti më dukesh pranë,  
sikur buzqesh e rrugën çan me mue...  
Dhe njëqind herë fati po të ishte dhanë,  
veç ty në jetë unë kisha me t'kërkue.

1952

## NUK DI SE SI MË LINDI DASHUNIA

Nuk di se si më lindi dashunia,  
nuk di se si u lidhëm na të dy.  
Porse më duket: gjithë vitet e mia  
sikur pérhera unë kam qenë me ty.

Në fund të dheut fshehun ti po të ishe,  
me falë po t'duhej ma se sa një jetë,  
porsi kalorës prrallash do të vijshe,  
ndër njëmijë shtigje ty kisha me t'gjetë.

S'të dashunoj si zanën mrekullore,  
që fërfërit n'mëndafshe anembanë, —  
si shokun por ma të afërt, që përdore  
kalojmë brigje e shtigje pranë e pranë.

**1953**

## PËRGJYSMË

Që kur e nisëm dashuninë  
na fjalët tona ligj i bamë;  
përgjysmë ndamë na lumtuninë  
dhe hallet gjyspërgjys i ndamë;

Çdo gja përgjysmë do e kemi n'jetë  
qysh se dy fatet i bashkuem.  
Kur njani frymëzim të ketë,  
do jetë dhe tjetri i frymëzuem.

Unë flas për ty e ti për mue  
si për vetveten, kush t'na pyesë.  
Dhe me ba fjalë e me u zemrue  
të drejtë na kemi gjyspërgjysë.

Në t'ardhmen vajzn' a djalin tonë  
përgjysmë do e kemi unë e ti.  
Por gjysmat tona gjithëmonë  
janë edhe mbeten vetëm nji.

1953

## **NA SOT MUND TË ISHIM DHE T' PANJOHUN T' VJETËR**

Na sot mund të ishim dhe t'panjohun t'vjetër,  
por ka në jetë një shteg, që t'lidh përherë  
vetëm me një dhe kurrë me ndonjë tjetër,  
me sy të tillë dhe kurrë jo me të tjerë.

**1953**

## **VEGIM**

Mbramë në andërr shumë unë ty të prita,  
Zemra sot më ndjell mue dashuni  
që në rreze t'parë sa çeli dita,  
n'këtë mëngjez të kthjellët sa u ngrita  
sytë e tu iu falën syve t'mi.

Më kujtohet: lulëzon pranvera,  
në një fushë me lule jemi shtrüe  
pranë burimit t'freskët n'andërrime,  
duert e tua bahan kupa ime  
dhe pasqyrë e kthjellët sytë e tu.

**1953**

## LULET

Të falnderoj për lulet pranverore  
që m'çon ti prej Shqipnie, e shtrenjta ime,  
nga thellësia e zemrës dashunore  
m'i prune këto lule dhe kujtime.

Pranvera ka fillue tek ne. N'hare  
lulzon Shqipnia e bukur porsi ti,  
me sytë e saj të gzueshëm — nuse e re,  
me zemrën që i rreh në dashuni.

Kto lule më kujtojnë mue sot dy sy  
të mdhej, të zez, nga pastërtia shkrue,  
që 'i dashuni të fshehtë mbrenda kanë ndry.  
nga lindja e diellit çdo agim drejtue,

qerpik't kunorë e vetullat gajtane,  
buzët në qeshje lehtë tue pëshpëritë,

njëzetvjeçaren me fytyrë zeshkane,  
që njëqind vjet po t'mundte kish me pritë.

Unë mirë ta njoh ty zemrën, që të vlon  
e dashunon në heshtje. Çdo pranverë  
me lulet ma të para më kujton  
që dheun e vendit ta kem pranë përherë.

Lules i ngjet atdheu ynë Shqipnia,  
që n'breg të Adriatikut lëshon dritë,  
ku porsi kroni buron dashunia,  
dhe ti, e dashun, — lules që shëndrit.

Unë lulet e Shqipnisë fort do t'i ruej  
porsi stolinë ma t'çmueshme në krahnor,  
ato do të jenë, ashtu si dy sytë tuej,  
frymzimi im, si dielli pranveror.

**1953**

## VASHA DHE TRIMI

Ç'ke dalë kaq heret, moj, në arë  
ende pa çelë agimi i parë?

Pranvera heret më ka zgjue,  
prashitje gruni m'ka kërkue...

Po dy gërshevat që gjarpnojnë  
as m'i fal mue, moj, se t'ngatrrojnë?

Shif punën tandem, ç'ke me to,  
ti rrugën mue mos ma pengo!

Unë do të marr, o moj perri,  
do të pushtoj në krahë të mi.

Jo, s'më merr dot, s'më ban robneshë,  
se bahem zogë e turtulleshë...

Skifter do kthehem unë at'herë  
dhe do të za, o moj e mjerë.

Nuk më merr dot. o trim i ri,  
se bahem erë, marr arrati...

Veriut krahët do t'ja marr  
dhe do të za, moj, ty plot zjarr.

At'herë unë Hanë do bahem fill,  
do fshihem revet nëpër qiel...

Unë yll do bahem përmbi to  
dhe do të gjej, moj, ty kudo!

**1956**

## D E S H I R È

Shumë un' kam dëshirë,  
do më vinte mirë,  
ti të ishe trandafil.  
unë të isha zog bilbil,  
mbi ty të qëndrojsha  
edhe të këndoshja

Unë të isha erë,  
ti të ishe qiparis,  
të vijshe përherë  
natën të bezdis,  
t'i përkdhelnja ziliqar  
fletët tua në behar.

Ti në mal të thatë  
të ishe burim,  
unë udhtar i ngratë  
djegun në udhtim,

të përkulesha etue  
dhe të pijsha pa pushue.

Me dy sytë e dëlirë  
jetën due ta çoj.  
Do ia çonim mirë,  
o ti shoqë moj!

**1953**

## MEDITIME PËR RAKETËN

Gjumi këtë nat' s'më zë, raketë,  
Këtu në lugin' të Shqipërisë,  
që u lëshove lart posi shigjetë  
si fitore e mendjes, e gjenisë!  
S'më zë gjumi sonte, arratinë  
mendja ime mori nëpër qieje;  
zemra thellë ndjeu krenarinë  
që Komuna lart u ngrit ndër dieje!

Pambarimin mendja ime çan.  
I mistershëm ndjehem dhe kozmik.  
Po kur shoh një drapër e çekan,  
përmbi tokën-nënë vij me vrik;  
dhe i them vetes: zbrit ti nën re  
dhe në tok' hidh çapin me guxim;  
nguli këmbët mirë te ky dhe  
që të fluturosh në pambarim!

Komunizmi është pranverë e jetë,  
komunizmi është ëndrr' e fluturim.

Ç'fuqi ka njeriu po tē ketë  
në gji zjarr pēr jetē e një qëllim!  
Ç'fuqi ka kjo dorë, që vampirët  
nëpér shekuj ty ta pren', Njeri!  
Po i zgjidhe duart nga zinxhirët,  
do tē zgjidhësh Prometenë e ri!

1959

KËNGE E RE  
PËR  
DASHURINË E VJETËR

(Poemë)

«Nga gulçimi buçet era,  
se rënkojn' e qajnë gratë;  
çlodhuni pak, moj të mjera,  
se punoni dit' e natë!  
Burrat vetëmë ju lanë  
dhe ripen ndë dhe të huaj;  
ata më keq nga ju janë,  
se ju rroni ndër vend tuaj.»

A.Z.Çajupi  
(*Malli i Shqipërisë*)

# I

Nuk e zuri gjumi fare mbrëmë  
dhe një vit iu duk kjo natë e gjatë.  
Asaj nuk iu ndanë hall' e gjëmë,  
si nuk ndahet era në shtërgatë!

Nuk e zuri mbrëmë gjumi fare  
jo pse ndrroi vend e shtrat, si thonë;  
as nga kënga e lehtë e asaj kitare,  
që në molo ndjehej natën vonë.

Ngritur ish nga shtrati disa herë,  
në ballkon të «Vollgës» kishte dalë;  
her' shih' detin që kish rën' të flerë,  
herë kthente sytë shihte djalë.

Në atë ças kushdo po ta shikonte,  
do të thonte: ësht' njeri me hënë!  
Asnjeri nuk mundej ta kuptonte  
ç'ndjente atë natë ajo nënë.

\* \* \*

Ndërsa tej në det po llamburinte  
një dritare e hekurt në të aguar;  
Xheladini në një fron po rrinte  
dhe vështronte brigjet i menduar...

Vall' në skelë cila do ket' dalë;  
Afërdita e bukur symëshqerë  
apo gruaja, që mori malë,  
që është kthyer në një plak' të mjerë?

Dhe shikonte veten në pasqyrë,  
tek rruhej, siç kish zakon, çdo ditë,  
flokët kishin marrë tjetër ngjyrë,  
nga fytyra ikur kish të ritë...

Sytë e saj ai kishëndërruar  
ndër ullishtet e Kalifornisë,  
sytë e saj si yje. «Por, mashtruar  
mos më kan' «të kuqtë» e Shqipërisë?

Mos nuk kam as djalë dhe as grua,  
mos nuk kam as vatër, as shtëpi?»

Kur sirena në ajër u dëgjua,  
asaj zemra thua se iu ngri.

Ajo kishte parë plot vaporë,  
gaz e lot prej tyre kish provuar,  
porse ky ja ndrydhte kraharorë,  
thua se mbi gjoks i kish qëndruar.

Ashtu siç afrohej drejt limanit  
ky vapor e gjithënë zmadhohej,  
asaj lëmshi në zemër i shtohej  
edhe ndjente vetëm zënë e xhanit.

Ky vapor qëndronte si një urë  
ndërmjet hidhërimit dhe gëzimit,  
ndërsa binte napa e agimit  
edhe era lehtas rrjh' flamurë.

Atë pa te shkallët e vaporit  
edhe sytë nga një cip' iu zunë.  
I gjëmonte drrasa e kraharorit,  
siç gjëmojnë veshët në furtunë. . .

\* \* \*

Aq i shpejtë qe ai vështrim  
që u kryqëzua ndër dy vetë,  
sa për një sekondë, një vegim,  
mund të shihje tërësisht një jetë.

Sytë e njëri-tjetrit në sy mbetën,  
si të ishin verbuar nga një diellë;  
sytë, që skalitin tërë jetën,  
ngazëllimin dhe farmak'n e thellë.

Ai me papjon i veshur ishte,  
ajo me fustan prej kombinati.  
ai pamje xhentëlmeni kishte,  
ajo si fshatare Progonati.

Djali këto çaste buzëqeshte,  
herë shihte të ëmën, herë të anë.  
Dhe kjo pamj' e rrall' në gji i reshtë  
një trishtim e, ndofta, tramundanë!

Ajo shihte burrin, djali të anë,  
burri përnjëherësh shih dy vetë.  
Që të tre ata lojtën një dramë,  
që në skenë zgjati njëzet vjetë.

Dhe kur molon drita e diellit kapi,  
gjokset nisën që të ndjenin zjarrë.  
Zemrat kishin marrë ritëm hapi,  
hapat ritëm zemre kishin marrë...

Edhe ndali hapin pak i zbetë,  
për një ças sikur e tundte deti;  
zgjati dorën ftohtë dhe i qetë,  
si i huaj gruan përshëndeti.

Ajo dhe pse pa sa kish ndryshuar,  
që kur zbriti, sa ja hodhi sytë,  
desh t'i hidhet fort në kraharuar,  
porse «jol» i tha një ndjenjë e dytë.

Desh t'i hidhet, deshi ta pushtojë,  
siç e pati rrokur kur qen' ndarë.  
Porse ndjenja s'mundi të fitojë,  
dhe i zgjati dorën zemërvrarë...

Po t'i shihte njeri këto duar  
si u zgjatën edhe si u dhanë,  
do të thonte: **kurrë dashruar**  
këta njerëz ndërmjet tyre s'janë!

Po dhe ndryshe ndodh, do thosh një tjetër,  
ndodh që për sho-shojnë japid kokën  
burrë e grua; dy dashnor' të vjetër  
edhe kur takohen, shohin tokën!

Ndodh, e çfar' nuk ndodh në këtë jetë  
por as ata vetë s'e kuptionin:  
dashuria ftohurë të jetë  
apo njëri-tjetrit ja mbulonin?

Djali atë çast i ngashëryer,  
pa ja paraqitur hiç njeri,

iu afrua të atit dhe rrëmbyer  
fort iu hodh në qaf' me dashuri.

Për një ças atij i erdh të qajë...  
kjo për njëzet vjet qe puthje e parë.  
Po pastaj sërisht nisi të mbajë  
ftohtësinë, mikën e pandarë.

Dhe s'do kishte gjetur njeri fjalë.  
në mes t'asaj heshtje tek qëndronin,  
po mos ja kish behur shpejt një djalë,  
një oficer që i foli: «Urdhëroni!»

Atij mendja prap iu turbullua  
me gjithshka dëgjuar kish më parë.  
Edhe kur doganës iu afrua,  
mendoi me vete: «Sa dollarë?»

Por surpriz' të tillë s'kishte pritur!  
Pes' minuta ndenji në doganë.  
Për dollarë as që e kishin pyetur.  
«Mund të shkon, shok, për në Tiranë..»

«Shok» ai në jetë s'kishte ndierë  
dhe iu duk sikur i ra nga qielli!  
Përmë akull thua desh të bjerë  
ajo fjalë si një rreze dielli!

## II

Shumë dashur qenë ata të dy  
që prej asaj dite q'u bashkuan,  
porsi në pasqyrë sy më sy  
njëri-tjetrit shpesh iu pasqyruan.

Ajo dashuri e vjetër s'ishte,  
s'ishin dashur që në fëmini,  
porse kishin vjedhur misërishte  
shpesh së bashku në arën përkarshi.

Shumë herë ai e ngiste kot  
dhe këmishën shpesh ja kish coptuar,  
por në dorë shenjë e kish dhe sot  
ku ajo me dhëmbë e kish kafshuar.

Kui fëmijët lozni në livadh,  
që të gjithë asaj i thonin burrë.  
Dhe pse pesë vjet ai qe m'i madh,  
në vrapiç asaj s'ja dilte kurrë.

Dhjetë vjeçë ishte, po kur fliste,  
ta kandisje më mos kishe shpresë.  
**Kur e thonte fjalën ajo e priste,**  
sic e pret malsori kur jep besë.

Ai gjithënë që këmbëçjerrë  
edhe në çdo punë fort nxitohej,  
shpejt e zgjaste dorën të të bjerë,  
po dhe shumë shpejt ai pendohej.

Miqësinë shpesh të dy e prishnin  
dhe me gjithse prindët qenë miq,  
dy fëmijë fqinjësh ata ishin,  
por qëndronin gjatë si armiq.

Dhe ndër mend ahere kujt i shkonte  
që këta armiq kaq kokëshkretë  
do vinte një ditë t'i bashkonte  
edhe prap t'i ndante njëzet vjetë?

Po një ditë toka kur qe pjekur  
edhe dega e mollës qe rënduar,  
ky babai i Xhelos fytyrmekur  
një babai fqinj i qe drejtar:

«Gjer më sot ta them më vinte rëndë,  
të ta them guxim mora tanë:

ti ke tokën, unë kam parmendë,  
a s'e lidhim këtë miqësi?»

Në të hyrë, në mejhan' të fshatit,  
dy duar të vrazhda krisën gotat.  
Pa së shpejti krisi Progonati,  
ra gërneta sa u tund gjith' bota!

S'ish e pasur dasma në të ngrënë,  
po e pasur dasma ish në këngë,  
që buçiten fort me diellë e hënë  
dhe i hapnin zëmrës gaz e brengë:

«Bjeri sot gërnetës,  
bjeri sot dajresë,  
që t'i japësh zemrës  
dritën e rrufesë!

Bjeri sot dajresë,  
bjeri sot gërnetës,  
që t'i japësh zërit  
forcën e trumbetës!

Ngreje sot dollinë,  
ngreje me raki,

që të shohësh ëndërr  
fusha-begati.

Dhe pse s'kemi tokë,  
muskuj kemi plot!  
Bjeri fort gërnetës,  
ta përbysim sot!»

Nja dy ditë ata do të pushonin,  
punë e rëndë i priste në të tretën,  
nja dy ditë mish do të shijonin,  
pastaj gjizë e qepë tërë jetën!

Ngazëllenin zemërat e reja,  
po përbrenda ruanin një hije,  
dhe u dukej pér një çast dajreja  
porsi lodërtare tragedije...

\* \* \*

Që të dy ata kthenin ugarë,  
në një torbë hanin edhe pinin  
dhe një herë s'i shihje të ndarë,  
përqafuar binin edhe gdhinin.

Këto vjet kaq mirë ajo ish thekur,  
kishte lulëzuar dhe gufuar,  
thua vetë dielli e kish pjekur  
ashtu siç pjek pemën e praruar.

Xhelua, që kurrë s'kishte ndjerë  
në ato sy magjinë e dashurisë,  
tani si i dehur ishte bërë  
nga aromë e lules së qershise.

Xhelua nuk qe dhe shumë i zgjuar.  
s'thuas dot se s'kishte shok të dytë,  
por kishte një zemër të qëruar  
ndaj e donte Dita si dy sytë.

Kur ndonjërin puna e kapiste  
edhe këmbët nuk e mbanin dot,  
njëri syresh zemrën do shqiste  
e për tjetrin do të derdhët lot;

me trupin e vet i bënte hije,  
fletë i kthente duart për freski,  
sa pa u afruar s'mund të dije  
ishin aty dy a një njeri.

Kaqe shumë u deshnë ata dy vetë,  
dashuri të tillë fshati s'njihte;  
dhe nga dashuria një i tretë  
doli këtë botë që të shihte.

Doli të kërcejë këtë valle  
që vazhdonte prindi gjë sa vdiste,

doli që të ketë uri e halle,  
ndofta mes për mes dhe që t'i priste!

Ata kishin bërë shumë fjalë  
për trashëgimtarin që do vinte...  
Dhe kur lindi djali: «Eh, ti djalë!  
Ti bandill!» ai përpjetë e ngrinte!

Edhe shtroi sofrën ta festonte.  
Ç'iu gëzua zemëra e mjerë!  
Nëpër mjergull ëndërre vështronte,  
sikur pasuria i erdh në derë!

\* \* \*

Por çdo ditë mehej pasuria  
që kur ky i treti erdh në jetë.  
U shit lopa, pastaj u shit dhia,  
mbeti plugu vetëm me dy qetë.

Xhelua punonte vetëm në arë  
dhe në mbrëmje kthehej i kapitur,  
ajo krah s'i jepte si më parë,  
se tani fëmija duhej rritur.

Dhe atë vit me të ardhur vjeshta e tretë  
— buka s'na mjafton — ajo kish thënë.  
Kish menduar ditën Xhelua vetë,  
dhe i vinte veten për të ngrënë.

Për të parën herë zemëruar  
jo me Afërditën, po me jetën,  
natën në dyshek kish mërmëruar:  
ku e kanë fshehur të vërtetën?

Xhelua dritëshkurtër qe në jetë,  
s'ish prej tyre ai, që, kur shikojnë  
botën rënë kokëtatëpjetë,  
kokëlart atë duan ta çojnë!

Por në atë minut nga ajo shpuzë,  
që mbuluar krejt nga hiri qe,  
krejt vetiu fjala i erdh në buzë  
si pema që bie vet përdhe.

Edhe ishte bërë që atë natë  
fort i ftohtë ai me të tjerë,  
sa së shoqes shpesh i thonin gratë.  
do ket' shkelur xhindër, moj e mjerë!

Xhelua të shoqen prapë e donte  
dhe përdit' më shumë donte djalë.  
Po dëshirë s'kish të kuvendonte  
dhe në mbrëmje s'thoshte asnje fjalë. . .

\* \* \*

Djali në të dytin kishte hyrë,  
ajo në të tretin mbi njëzetë.  
Thatësia atë vit mynxyrë  
e kish djegur fare bereqetë.

Dhe par mendë e ndryshkur kishte mbetur  
si blindazh nga lufta shkatërruar;  
të dy qetë me të zotnë e tretur  
posi robër lufte dorëzuar.

Kishte shitur Xhelua atëherë  
të dy qetë e punës dhe shtëpinë  
dhe së motrës i kish rën' në derë  
me të shoqen dhe me ciliminë.

— Do të iki unë, Afërditë,  
fati vetë nga ky vend më ndoq, —  
sytë e saj më sikur s'patën dritë,  
dhe për or' të tëra u përpoq.

— Do tē rrojmë plisat duke thyer,  
por tē pakën, Xhelo, ésht' dheu yt. —  
Porse Xhelon keq e kish mbërthyer  
frika e jetës, pos i dar' në fyt.

— Do tē bëj andaj para me punë,  
që tē vëmë dhe ne pasuri. —  
S'dinte se g'e pret, diell a furtunë,  
kish dëshirën «të fitoj» në gji.

— Xhelo, djali shpejt ka pér t'u rritur,  
do na bëhet krah pér tē fituar! —  
Mbushur lot ajo ja kishte pritur.  
Ai fjalën nuk ja kish dëgjuar.

Pér tē parën her' ndryshe mendonin  
që kur zuri rrënë dashuria;  
në sy njëri-tjetrin s'e shikonin,  
thua përsëritej fëminia. . .

### III

Ajo hije burrë ish apo grua,  
që i binte arës pa pushim  
me hosten në dorë e dukej thua  
se një valle hiqte pa mbarim?

Fort e vjetër ajo valle ishte;  
skenë fushën kish, shelgjet lotues,  
vegël ajo vet' parmendën kishte,  
spektator kish diellin përvëlues!

Ajo hije grua qe dhe burrë,  
short i tillë në jetë i kish rënë.  
«Baba» djali s'kish thërritur kurrë,  
s'dinte ç'ndryshim kish «baba» dhe «nënë».

Dy detyra kish ajo në jetë:  
një e bënte të ish e ashpër shumë,  
tjetra e bënte të ish e butë, e qetë  
dhe me këngë atij t'i ndillte gjumë.

Në ata plisa djali ishte rritur  
dhe kish mbushur pesë atë pranverë,  
ish rrëzuar edhe prap ish ngritur  
pas par mendës ai qindra herë.

Oh, po kur do vinte ditë e madhe,  
kur do ngrihej edhe s'do rrëzohej  
dhe gjyqtar i rrept' për këtë valle,  
që hiqte e ëma, do të çohej?..

Përcëlluar ishte nënë diellë,  
i qe nxirë dhe lëkura e tretë  
dhe fytyra dukej brazdë e thellë,  
ku kaluar kishte plugu-jetë.

Porse nuri jo, s'i ishte tretur,  
sytë kishin prapë bukuri.  
Ajo dukej posi tokë e etur,  
që është tharë vetëm për një shi.

Edhe vlagën sërish me ta marrë  
pjek kallirin, pjek edhe bostanë,  
ndaj kapteri vëngër e kish parë  
kur kaluar kishte aty pranë.

Dhe në mbrëmje pritën i kish zënë  
ai gruas, që vinte me djalë.  
«Mirë mbrëma» lehtas i kish thënë,  
i krekosur para i kishte dalë.

«Mirë mbrëma» ajo qe përgjegjur  
dhe kokulur bregut iu drejtua.  
Po kapteri, ai ujk i regjur,  
iu afrua dhe i tha: «Të dua»!

«Dua j gruan!» ajo shkurt ja preu.  
«Ty të dua!» briti i zemëruar.  
Dhe damari i ballit i kërceu,  
si përbindësh iu hodh me dy duar!

Tërë forca që kish ajo grua,  
ajo grua që ish baba dhe nënë,  
me urrejtjen zemrës iu bashkua  
atë mbrëmje pranvere pa hënë!

Djalë i vogël, që kish mbetur prapa.  
zënë e saj kur nisi të dëgjojë,  
vrapin mori, hodhi dhjetë hapa  
edhe nisi të ëmën të ndihmojë!

Mbi kapterin u hodh duke britur,  
duke e çjerrë, duke e kafshuar;  
thua djali sonte ishte ngritur  
kurrë plisash më për t'u rrëzuar!

Porse hije e errët, që u mund,  
pasi u zvarris dy a tri herë,  
si u ngrit më këmbë dhe u shkund,  
armën nxori për të mbrojtur «nderë!»

Edhe desh e vau për një grimë,  
që nga farkëtorja, në të kthyer,  
një djalosh mos dalkësh vetëtimë  
dhe nagantin mos ja kish rrëmbyer!

Mu në nofull grushti e qëlloi.  
Qindra yje panë sytë e nxirë.  
Pastaj porsi hije fluturoi  
dhe u zhduk djaloshi në errësirë...

\* \* \*

Monotone vitet shkonin, thua  
përsëriste çdo vit vitn' e parë.  
Ajo nënë burrë ish edhe grua,  
që hiqte një valle në atë arë...

IV

Përmes udhësh mbushur me reklama,  
ku përbyste firm' e re të vjetrën  
dhe pizhamat vareshin ndër xhamë,  
dy opinga ndiqnin njëra-tjetrën.

Njëri qeshte leht' me ironi,  
me shikimin-akull një i dytë.  
E vështronin sytë me çudi  
dhe ai me çudi vështronte sytë.

Disa sikur thonin: — Je në vete?  
Dhe të tjerët: — Ti këndeje çfar' deshe?  
Kish trokitur nëpër kabaretë,  
kish baritur nëpër shumë sheshe;

pa u falur yjet ngrihej heret,  
lante pjata, gjer në agim qëllonte.  
Siç ndryshonin dama kavalierët  
dhe ai padronët i ndryshonte.

Posi zgavra sytë i qen' thelluar,  
thua gjumi rëndë i kishte kotur.  
Ndofta mbrëmë kishin ndenjur zgjuar  
duke ëndërruar të përlotur?

Po, po, malli e kish marrë shumë  
për një arë, për dy silueta...  
por vendosur kish të rrrij' pa gjumë,  
të fitonte ca para të shkreta;

që në fshat të kthehej e të blente  
ndonjë ar' me ujë e një shtëpi  
me «qerpiq të kuq» aty të ngrinte,  
që ta shihte «kulla» me zili...

Porse shpresat shpejt qenë verbuar,  
sikur pritë i dolën Himalatë,  
veç opingat ai kish ndërruar,  
për këmishën blerë kish kravatë;

pasuri s'të falte Evropa,  
siç ahere ëndërr e kish parë;  
Evropa donte mish pér topa  
dhe jo duar pjata pér të larë!

\* \* \*

Dhe vazhdonin udhë ato këmbë  
edhe njëra-tjetrën ngatërronin  
dhe i vinte shpirti mu në dhëmbë  
«s'ka më punë!» kur e lajmëronin.

Edhe në Paris kishte jetuar,  
por Parisi atë e kish parë.  
Vetëm ca taverna kish shikuar  
dhe ca njerëz ndër trapeza ndarë.

«S'na sulmojnë!» jakëngrirët thonin.  
«Mazhinoti do të jetë varr!»  
Por dokerët vëngër i shikonin  
dhe më kupë i hidhnin gjoksit zjarr.

Lioni pastaj. Transatlantiku...  
për udhtim të largët ishte nisur.  
Nga Evropa ai natën iku.  
që të gjente fatin e bitisur.

Kjo kala e madhe sikur fliste  
për jetën që bënин ato brigje.  
Mbrëmjeve në salla xhazi kristë  
edhe veshja e grave s'nnihi ligje.

Në katet e para qe paria,  
njerëzit e bankave, të kasës.  
Dritare-dritare hirarkia —  
kurse ky udhtonte «jashtë klasës».

Dhe kur në Nju-Jork portat u çelën,  
ish qytet a vend i shenjtëruar?!  
Me vështrimin humbur sytë i ngelën  
thua fare qe hipnotizuar!

Por nga shpejtësia u çudit  
që iu xhvat valixhja dhe s'u pa...  
Ja, kështu e prenë atë shirit  
këmbët me opinga në SHBA!

V

Ka zogj që gjith jetën fluturojnë  
edhe vdesin duke flutruar,  
ka dhe zogj që plehrave rrëmojnë  
dhe në çerdhe ngordhin të harruar. . .

\* \* \*

Që nga Nili i largët shtërgjet vinin  
dhe, në Drin e Vjosë me të sosur,  
shihnin lart në qiell si shqipet binin  
përmbi dhe me krahë të gjakosur.

Për ato nuk binte kambanë,  
s'kishin në varrim shqiponjat-nëna,  
si nderim gjëmonin anembanë  
vetëm breshëritë me të shtëna!

Ç'vdekje ish ajo! Sikur nuk vdisnin,  
bula trëndafili e mbushnin qiellin,  
sikur në një vazhdë drite shkisnjn  
për t'u pjekur atje lart me diellin. . .

Bukuri e shqipes s'kish të ngjarë  
kur në qiell lart e falte jetën  
dhe, sa herë shtërgu e kish parë,  
ulej Vjosës, Drinit lagte fletën;

në ujët e gjakosur fletën lante,  
ku shqiponjat trime qenë shtrirë,  
që në krahë atyreve t'u ngjante  
kur të shkonte larg në shkretëtirë...

\* \* \*

Natën djalit kur i vinte gjumi  
edhe sytë i mbylleshin ca pak,  
i tregonte nëna ç'është lumi,  
ç'është dhelpra edhe ujku plak.

Por jo, sonte djali s'donte prralla  
dhe nuk po i vinte qorri gjumë,  
nga s'i shkonin sytë nën qepalla  
dhe i bënte nënës pyetje shumë.

— Pse të flerë e vumë ne tavan  
mikun që na sollën në shtëpi?  
— Ai, biro, është partizan,  
e kërkojnë armiqtë me qiri.

— Ç'do të thotë fjala partizan  
që dëgjuar shpesh e kam, nëno?  
— Partizani për liri-vatan  
as dhe jetën s'e kursen, biro.

— Ç'është vatani, nënë, dhe liria,  
që në këngë dëgjohen gjithmonë?  
— Bir, vatani është Shqipëria  
dhe liria ështëjeta jonë.

— Po fytyra e tij përse ish zverdhur  
dhe këmisha ish e kuqe flakë?  
— Në betejë, biro, gjak ka derdhur,  
se në kraharor ka marrë plagë...

\* \* \*

Kaqe ditë ajo e kish mjekuar  
edhe natën shpesh e kishte gdhirë,  
porse sytë s'ja kishin shikuar  
njëri-tjetrit ata në errësirë.

Shpesh të mirën kur e bën, njeriu  
e fsheh dorën, tjetri turp mos ketë.  
Kur të mirë i bëjnë, syt' vetiu  
ulen e vështrojnë tatëpjetë.

Po një çast dy sytë e tij u ngritën  
dhe, përmes një rrezeje të thyer  
në fytyr' të saj llamburitën,  
shkuan te naganti i rrëmbyer...

Si? Ti thoshte vallë, që atë natë  
e kishte shpëtuar prej kapterit?  
Kjo për partizanin ish lëvdatë,  
ndjente krenari dhe turp njëherit.

Por ajo e pa se si shëndritën  
ata sy, kur mu në sy e panë;  
si rrufe në mendje solli pritën  
dhe mornica prap në trup i vanë.

Ishte kallajxhiu vetullngritur,  
që bariste fshat më fshat ahtere;  
q'Afërditën e shpëtoi papritur  
dhe s'u duk më prej asaj pranvere...

Ritmi i zemrës asaj i ndryshoi,  
siç ndryshon kur ndjen për her'të parë  
dashurinë. Por nuk e tregoi.  
Dhe i hoq fashën, plagën për t'i larë.

Sytë e mendjes shpesh atë fytyrë  
nëpërëndrra e patën shikuar;  
dhe kapteri kur «trego» qe shfryrë,  
kallajxhinë nuk e pat treguar!

Desh t'i thotë — Jam shum' e gëzuar,  
(flas në emër të zemrës, të vërtetës)  
që mik në shtëpi sot të kam shtruar  
dhe që je ti komandant i çetës!

Porsa buza s'mundi dot ta shpjere  
urdhërin e zemrës në vend.

Ndjenja s'e çan udhën dot, shpeshherë,  
kur nis me logjikën bën kuvend.

Edhe s'i tha kurrë asnje fjalë  
— do të flasim, koha kur ta sjellë —  
Dhe herë ulej poshtë, shihte djalë,  
herë conte lart ujë edhe gjellë. . .

... Ditët fluturonin e më s'kthenin,  
plaga pak nga pak po mbyllej fare.  
Fshehtas ata miq veten e ndjenin  
që nga mbrëmja e largët kaqvjeçare. . .

Për një muaj rresht, mik i shtëpisë  
shpejt u bë ai. Edhe ndajnatë  
zbriste me ngadale prej çatisë,  
hidhte me kujdes çapin e gjatë.

Ajo vatër, burrë që s'kish parë,  
tani erë burri kishte; thua  
frika, që ish mike e pandarë,  
nga të katër sytë u largua.

Djali zu lexonte abetare  
dhe të shkruajë emërin arriti.  
Atë që s'e bëri babai fare  
po e bënte partizan Reshitit.

Këtë kohë larot bridhnin fshatit  
dhe lart në çati dy sytë **ndrisnin**.

Lufta kristë afër Progonatit,  
partizanët komandantin prisnin...

## VI

Ai qe shëruar, s'kish më plagë.  
Kishte hyrë tani vit i dytë.  
Po ka plagë, që djegin si flakë,  
hapur jo nga plumbi, po nga sytë...

\* \* \*

Që kur iku Xhelua atëherë,  
pasi kishin shkuar kaqë vjetë,  
ajo atë dorë kishte ndjerë  
që i duhej kaqë shum' në jetë.

Ajo dorë ishte posa darë,  
tërë kallo shkuar e pëershkuar;  
ajo dorë ishte plot damarë  
në ngjyrën e detit të zemruar.

Gjith' shuplaka pulla-pulla vinte,  
ciklat e kallait kishin mbetur,

dhe gishti tregues përkulur rrinte  
nga që plumba mbi armiq kish tretur.

Ajo dorë qe për të adhuruar,  
frika zhdukej, po ta kishe pranë,  
ajo dorë atë e kish shpëtuar  
atë natë, kur rrëthimin çanë.

Do kish mbetur ajo me gjith' djalë,  
do të ish djegur bashkë me shtëpi,  
ajo dorë po mos t'i kish dalë  
shpëtimtare në atë stuhi!

Dhe kaluan pyje e livadhe  
nëpër tym baroti, pos i re.  
Për të s'kish më lumtëri të madhe  
se të rronte me ata mbi dhe!

Dhe kur djali o ajo rrëzohej,  
ai rendte shpejt që t'i ndihmojë,  
i ngrinte më këmbë, pastaj çuhej,  
pastaj u qëndronte praparojë!

Ajo atë dorë ëndërronte,  
t'i lëmonte ballin, syt' gështenjë.

Po sa herë që kështu mendonte  
e shtrëngonte fort një parandjenë!

Sytë e tij shikonte ballpërballë,  
që prej vitesh s'kish dërguar letër.  
Në ato vise ai ç'bënte vallë,  
është gjallë, të ket, marrë tjetër?

Dhe një mëndje i thoshte: duhet pritur!  
Po një tjetër: flake derëzinë,  
që s'qëndroi djalin për të rritur,  
para teje — zgjodh Ameriqinë!

Sic përplasen dallgët nga stuhia,  
zemra i rrihte fort gruas së mjerë.  
Urrejtjen e ndan nga dashuria  
veç një fill i hollë nganjëherë.

Dhe këto dy ndjenja e mundonin  
kur në çetë ai e përshtëndeste,  
kur dy duart djalin lëdhatonin  
dhe ajo aty memece mbeste...

\* \* \*

Vetullat e djegura nga flagët  
ngryseshin shpeshher' mbi sytë e zi.

Ajo, q'i shëroi atij plagët,  
plagë i kishte hapur përsëri;

plagë që s'e lë njerin' të flerë,  
plagë që rri hapurë për jetë,  
plagë që s'shërohet kurrnjëherë,  
po nuk u bë fashë zemra vetë!

Kurrë ai në jet, s'kish dashuruar,  
dashurisë nuk i njihte emër.  
Kur shokët e tij qenë martuar,  
atij tjetër gjë i rrih' në zemër.

I kish thënë nëna: bir o djalë,  
erdhi koha nusen për të zënë;  
ai thënë «jo» s'i kish me fjalë,  
po dhe «do martohem» s'i kish thënë.

Fshat më fshat ai kish kallaisur  
me një thes në krahë shumë vjetë.  
Dhe të shohë vetë i kish rastisur  
ç'piqej në kusitë e tenxheretë!

Dhe njëherë, mbushur zemëratë  
kundër dhunës, fort i ra kapterit.

Edhe mori malin që atë natë,  
iu bë shok nagantit, maliherit!

Maleve u end dhe pyjeve.  
Nuk e zinte dot asnje xhandar.  
Ekte nënë dritë të yjeve  
deri sa u poq me një Pishtar!

Me të morën udhën nëpër flagë  
dhe gjëmuan malet nga rrufetë.  
Në betejë ai mori dy plagë,  
tani mori dhe plagën e tretë...

... Në ata sy sikur iu pasqyruan  
të gjitha ëndrrat, që në emër kishte.  
Do t'i thosh ai asaj: të dua!  
ligji i rreptë partizan mos të ishte;

po, të dua, ai do t'i thonte,  
po mos të ishte në prak robëria.  
Priste ditën lufta të mbaronte,  
kohën që kërkon vet' dashuria...

Dhe luftonte dyfish i harbuar  
mu në ball' të sulmit partizan;

të shpejtonte ditën e shënuar  
kur t'i thonte: Afërditë, xhan...

\* \* \*

Në bregore krisën breshëritë!  
Një shqiponjë për në diell u ngjit!  
S'i tha dot asaja: Afërditë!  
As ajo nuk i tha dot: Reshit!

Njëri-tjetrit ata nuk ja thanë  
fshehtësinë që kishin në zemër.  
Po me zemrat pranë ata u ndanë,  
dashuria s'mbeti e paemër.

Ra shqiponja përdhe e gjakosur  
duke ëndërruar dashurinë.  
Po t'ja shihje sytë në të sosur  
do vëreje në to gjeraqinën...

Gjeraqina tani mbet e shkretë  
dhe fëmija prapë si jetime,  
po në zemër skaliti për jetë  
syt' shigjetë të shqiponjës trime!

## VII

Kishte qarë shpesh duke menduar  
dhe sa herë gjumi i kish dalë,  
kur në ëndërr fshatin kish shikuar,  
vatrën me një grua dhe një djalë.

Gjysmëfjetur shihte shpesh ai  
sikur grataçuela e kish zënë  
dhe mbulonte kokën si fëmi  
që e frikëson nata pa hënë.

I përlotur, këngë shumë herë  
pranë Missisipit kish kënduar.  
Ndonjë mister fqinj kur e pat ndjerë,  
shpesh e kish pandehur të shkalluar.

Ku ta dinte misteri ç'do thotë  
ajo këngë e ato fjalë zvarrë:  
«Valë e Vjosës, seç m'i mbushe lotë  
këta sy, q'u dogjën për të parë!»

Dhe të kthehej desh ai një vit'  
Zemra mallin më nuk ja duroi.  
Po nga heshtje e gjat' fort u çudit  
dhe në tradhëti ai dyshoi.

Posi fqinje meurrejtjen malli  
në ata sy të ngrysur shpesh jetonte,  
dhe nga dëshpërimi rrudhej balli,  
luftën dhe urinë kur mendonte.

Po kur i thosh mendja se martuar  
me një tjetër ajo do të jetë,  
shpesh në zemër thellë kish provuar  
ftohtësinë e peshkut zën' në rrjetë...

\* \* \*

Amerika të thëthin të ritë,  
si shushunja gjakun në damar.  
Po i mpakeshin, atij fuqitë,  
siç i mpaken diellit në janar.

Ditët shkonin dhe atij i dukej  
si legjendë gruaja, fëmija.  
Pas banakut Xheladini strukej,  
dhe më thellë strukej Shqipëria...

Ai me vetminë qe mësuar,  
shoqe kishte zënë qetësinë.  
Etiketën ai kish fituar,  
kish fituar edhe ftohtësinë.

Ai aqë shumë ishte kapitur  
nga stafeta që kishte përshkuar,  
sa s'kish forcë për të përtëritur  
në kujtesë as shtigjet e kaluar.

Keq i vinte që në kët' stafetë  
asnjë ndjekës s'do të linte pas.  
Po kështu e shkruar qe në jetë  
Edhe s'kish më hidhërim as gas.

Po të kenë vdekur, paçin ndjesë!  
Po të jenë gjallë, qofshin mirë!  
S'i ndihmoi kur qe njëst e pesë —  
njëqind herë tanë qe vështirë!

\* \* \*

Kur i erdh letra, u gëzua  
që ndonjë e keqë s'u kish ngjarë.  
Po gëzimi i tija shpejt u shua  
edhe nisi prap zymti e parë.

Të thuash të drejtën, mir' s'e priti  
gruaja, në mal që kishte dalë.

Dhe kur tërë letrën e lëçiti,  
dot s'i kish kuptuar disa fjalë..

«Xhelò prap vuajm', s'e mohojmë  
edhe triskë buka e gjërat kanë;  
të pangopur ne shpeshher' punojmë,  
porse t'ëmbla vuajtjet na janë...»

Vuajtjet të ëmbla? S'e kuptonte  
Afërdita këtu ç'do të thotë.  
Dhe ndër buzë ai belbëzonte:  
ku ka halle t'ëmbëla në botë!

Dhe mejgjithse ai s'kish ndër mend  
që gjysmënjeriu të këthehej,  
keq i erdh që «eja» n'asnje vend  
fjala e Afërditës fare s'ndjehej!

Me zymtinë, miken e pandarë,  
Afërditës i shkroi dy radhë,  
sa që ajo, kur letrën kishte parë,  
tha: të jetë ai a tjetër vallë?

\* \* \*

Ka njerëz të tillë përmbi dhe,  
që në pamje duken si të vdekur,

po q'u shkrepin sytë si rrufe,  
në një tel të tyre t'i kesh prekur.

Ai nuk e prishte qetësinë.  
Po Departamenti kur e kish  
thirrur për të ndrruar shtetësinë —  
nuk e ndjeu veten peshk as mish!

Dhe iu duk se më e fundit shenjë,  
që e mbante përmbi dhe, e pat!  
Dhe iu duk se më nuk ish i denjë  
as dhe për një varr në Progonat!

Veç një shtytje donte, që në re  
lart ta conte ai zënë e ti:  
Shqipëri, ti falmë një pash dhe,  
falmë një varr mua, Shqipëri!..

... Dhe kjo shtytje erdhi. «Xhelò im,  
djali është rritur, u bë burrë  
dhe sot ikën jashtë për studim.  
Ke vendosur mos ta shohësh kurrë?!

S'duam ne para, s'duam dollarë!  
Flet një shoqja jote, flet një nënë!»

Dyzet vjeç guxim ajo kish marrë  
që t'i klithte burrit me gjith' zënë!

\* \* \*

Çante valët prap «Transatlantiku»,  
ku dikur pat hipur pikë e djalit...  
Tërë muskuj ai qe kur iku,  
që trofe ja fali kapitalit.

Dhe sot vinte thinja krejt mbuluar,  
prapa diellit lënë e kish rininë.  
Dhe shtrëngonte fort në ato dy duar  
dy valixhet, tërë pasurinë...

## VIII

Heshtje. Asnjeri s'thonte një fjalë.  
Ç'fjalë në ato çase mund të thohej?  
Tej dritares ndiqte vala valën  
dhe, si zemra, brigjeve thërmuhej!

Oshëtimën era e detit sillte,  
të stuhis' së largët oshëtimën.  
Dhe në zemrat e të treve ndillte  
ritmin e shfrenuar, psherëtimën.

Djali, që e la sa erdh në jetë,  
për një ças i dukej si i huaj,  
posi gruri që s'e korri vetë,  
që s'e mblodhi vetë nëpër duaj.

Afërditës sytë kur ja hodhi,  
ndjeu gaz njëherit dhe trishti.  
Në dy sytë e saja mendja i brodhi  
si në det me dallgë në stuhi.

Nënë e bir mbi të hodhën vështrimin  
si mbi një zbrazti të zemrës vet,  
që të mbushej donte njëzet vjet,  
qëkur ai nisi larg shtegtimin.

Zor ishte të dilte fjala e parë.  
Fjalë s'duhej ktu, duhej fuqi!  
Sytë që të mbeteshin të tharë,  
retë të mos ktheheshin në shi!

Dhe njeri s'e prishi qetësinë.  
Flet më fort nga fjala heshtja vetë!  
Zemra e tij po merrte ngrohtësinë  
posi një i ngrir' që vjen në jetë!

\* \* \*

Drejt kryeqytetit treni shkonte  
dhe tre vetë shihnin në dritare,  
q'ë vështronin botën ndryshe fare.  
Për atë tunel djali tregonte:

— Ja këtu, baba, ne ditë e natë  
gemë me brigadat e rinisë  
dhe i dhamë në nëndor dhuratë  
hekurdh'n e parë Shqipërisë...

— Mir' paguhet puna nënë dhe, —  
shtoi ai, — dy vjet me të jam marrë...  
— Por — tha djali, — ç'kohë e bukur qe  
ajo kur ne ishim vullnetarë!

Nënë e bir e bënë me durim  
kthesën në ndërgjegje ka shum' vjetë.  
Ai do ta bënte kët «pastrim»  
— s'ish e lehtë — sot, në pesëdhjetë!

Por ai nuk erdh për t'u pastruar  
në ndërgjegje, as të kërkonte fat.  
Tjetër ktu, kur erdhi, kish menduar:  
veç një varr të kish në Progonat!

Dhe qe shpesh gati të thosh në vaj:  
«Shqipëri, ti jepma varrin tim!»  
Porse nëna e do djal'n e saj  
dhe e qafon në gaz e hidhërim.

Mjafton që asaj zemrën t'i hapësh,  
ajo të jep vend në gji të vet;  
mjafton që asaj dorën t'i japësh,  
për gabimet kurrë ajo s'të flet!..

Treni nëpër muzg shkëndij' lëshonte,  
thua ndër to endej lumtëria.  
Xheladini vdekjen po mendonte —  
për në jetë e ftonte Shqipëria!

\* \* \*

Atë natë zemra asaj i rrithë  
si mbrëmjen e parë që u bë nuse.  
Kish në gji dy ndjenja përvëluese  
dhe njëra nga tjetra kokën fshihte.

Xhelon dashur shumë ajo e kish.  
Por kjo ndjenjë pastaj i qe ngrirë.  
Lulebore mbi të kishte mbirë,  
kur larguar Xheladini ish.

Si t'ja thonte cilin kish takuar,  
se i kish hapur dikur plagë vallë?  
Dhe mbi lulebore kish buluar  
trëndafili i tija flakëallë?

E pse s'kish të drejtë ajo të donte  
atë dcrë që mburojë e pat,  
Xhelua, kur la shtëpi dhe fshat  
edhe s'bëri atë q'i takonte?

Xhelo, tjerë qenë ata, që botën  
kokëlartë e ngritën, s'ishe ti!  
Ike ti, se frikë pate shqotën  
dhe le shkretë grua dhe fëmi...

\* \* \*

... Zemr' e gruas është si gastare,  
që nga zjarri e akulli pëlçet.  
Atë nuk e zinte gjumi fare,  
rrrotullohej në jastëk të vet.

Zemr' e gruas është e gjer', bujare,  
dhe ja fal mërinë dashurisë;  
fal gabime, fal edhe zarare,  
siç fal zemra e madhe e Shqipërisë...

Tërë natën ajo s'bëri tjetër  
veç dëgjoi zemrën në gji.  
Këngë e re për dashurinë e vjetër  
po fillonte prap në atë shtëpi...

**1959**

## BOTA E SINQERTË E POETIT

Vëllimi me vjersha i Drago Siliqit është një përbledhje e krijimeve të tij poetike kryesisht të viteve 50.

Edhe tani, disa vjet pas vdekjes së tij, vargjet na duken gjithmonë të reja, me një ndjenjë të sinqertë e të gjallë. Zemra e poetit, që u nda aq dhimbshëm nga gjiri ynë na flet përmes këtyre vargjeve. Ne e çfletojmë këtë vëllim dhe ndjejmë kudo fjalën e ngrohët, të menduar, shpesh të gjetur bukur, të një njeriu që doli krejtësisht nga shoqëria jonë socialiste, që përfaqëson mirë brezin e tij, i cili u rrit me pushkë në krahë, apo duke breshur nga njeri repart partizan te tjetri, me detyrën e partisë, duke u hedhur si korier i luftës nga fshatrat e çliruara në qytetet e pushtuara. Jeta e këtij brezi zuri fill në luftë dhe u kalit me ndërtimin e socializmit, me marshimin e revolucionit tek ne, me rrënjosjen e ideologjisë së partisë në zemrat e të rinjve, me zhvillimin dhe thellimin e kulturës së re socialiste. Drago Siliqi ishte një ndër ata të rinj që i përvetësoi dhe i ndjeu thellë mësimet e partisë, që iu vu me

*gjithë shpirt punës për të njohur kulturën kombëtare dhe kulturën përparimitare botërore.*

Njohja e jetës, pasqyrimi i rrugës së bërë nga brezi i tij, psikologjia e këtij brezi dhe pasurimi i mendimit, përvetësimi i kulturës janë tipare që vihen re në poezinë e Drago Siliqit. Vjershat e këtij janë vjersha të një revolucionari të vërtetë që gjithçka — atdheun, familjen, natyrën, dashurinë, marrëdhëni et midis njerëzve, transformimet nëjetën tonë — i sheh me syrin e komunistit që përfaqëson kurdoherë njeriun e ri dhe të pastër shpirterisht. Në këtë pasqyrim shumë të singertë të vetvetes dhe në faktin se ai vetë u takonte njërezve, shoqërisë sonë, këtu qëndron vlera kryesore e këtij vëllimi. Natyrisht, kjo është themelore për poezinë dhe për artin përgjithësisht, sidiqë duhet marrë e lidhur ngushtë me mundësitë krijuese të çdo autori, me shprehjen poetike të mendimeve, ndjenjave, të botëkuptimit. Edhe nga kjo pikpamje poezia e Drago Siliqit ka meritat e saj, përfaqëson ato tendenca dhe atë evoluim që ka qënë karakteristik për letërsinë tonë, për poezinë veçanërisht.

Zbulimi i plotë i vetvetes para lexuesve, para shokëve të vet, shoqërohej me një punë këmbëngulëse të poetit për të gjetur fjalën artistike, shprehjen shqip, ritmin dhe rimën e zgjedhur, si pas natyrës së poezisë sonë.

*Nuk janë të gjitha poezitë e këtij vëllimi të*

të njëjtët niveli. Kjo është e kuptueshme. Nuk është gjetur gjithmonë çasti poetik dhe nuk është realizuar dot gjithnjë sa duhet mendimi i gjetur bukur. D. Siliqi ishte kërkimtar ndaj artit dhe, në mënyrë të veçantë, ndaj poezisë së tij. Ai nuk kënaqej nga vargjet e tij dhe mendohej shumë për të botuar përbledhjen poetike. Natyrish, poezia jonë në vitet 60 ka ecur përpara. D. Siliqi do të ekte pa dyshim me kohën dhe vëllimet e tij do të ishin të një niveli edhe më të lartë. Ne e themi këtë me bindje se e tillë ka qënë rruga e tij poetike gjatë viteve 50, një rrugë në rritje, në zhvillim, me një depërtim më të thellë në botën e njeriut dhe me mendim poetik më të phekur.

Vëllimi i D. Siliqit është një dëshmi e poezisë së kohës kur u krijua, e jetës dhe botës shpirtërore të poetit, që përfaqëson gjer në fund brezin e tij të të rinjve të rritur në luftë për liri dhe për socializëm.

Poezia e D. Siliqit është një poezi në radhë të parë lirike me prirje nga meditacioni dhe analiza psikologjike. Rrethi i temave që ka tërhequr vëmendjen e poetit është i gjerë dhe ka ardhur duke u zgjeruar me çeljen e horizonteve të reja të autorit. Përbajtjen kryesore të vëllimit e përbëjnë motivet e patriotizmit, të dashurisë për atdheun, motivet e transformimeve shoqërore dhe morale në ndërgjegjen e njerëzve, motivet e dashurisë për veprën.

Prirja e poezisë së D. Siliqit drejt meditacionit, mendimit më të thelluar dhe analizës psikologjike dëshmon për përparimin poetik të autorit dhe vihet re më shumë në krijimet e mëvonshme të tij e më pak në krijimet më të hershme. Prirjet që zura ngojë janë një veçori e kësaj poezie, po flasin gjithashtu edhe për tendencën më të përgjithshme të poezisë dhe të letërsisë sonë drejt realizmit, për një konceptim dhe zbatim më të thelluar të metodës së realizmit socialist tek ne. Në poezitë e Drago Siliqit, si edhe të shumë poetëve të tjerë bashkëkohës u bënë më të qarta kërkimet për të hyrë më thellë në ndërgjegjen e njeriut tonë, për të shprehur botën e tij të bërë dëshme në kompleksin e vet, me ngjyra më të shumta dhe më të bukura poetike.

D. Siliqi, siç dihet dha një kontribut të çmueshëm si kritik dhe shumë mendime të tij mbi letërsinë tonë, mbi rrugën e poezisë, vlerësimet e drejta dhe objektive tingëllojnë sot në mënyrë aktuale. Ato të gjitha janë të përshkuara nga fryma e partishmërisë. Konkluzionet që ai nxirrte në kritikat e tij kanë gjetur shprehje edhe në poezinë që krijonte. Ka një koherencë të plotë midis mendimit kritik dhe artistik. Ai fliste, për shembull, për zhvillimin e poezisë sonë, e shihte atë në prizmin historik dhe vërente se poezia e fundit e viteve 50 dhe fillimit të viteve 60 dallohej nga një «soditje më e hollë e këndeve të fshehta e të

*padepërtuara të individit». Ai ishte për një poezi konkrete, po jo për një grumbullim detajesh. Analiza psikologjike në poezi, sipas mendimit të tij, duhej t'ia zinte vendin këtij grumbullimi pa kriter të hollësive të tepërtë.*

*Ai ka qëndruar besnik i këtyre punimeve estetike dhe, në krijimet e tij më të mira, këto gjëjnë një shprehje të bukur artistike.*

Në poezitë e bukurës dhe me ndjenjë të thellë si «Atdheu», «Një yll në breg të Jonit», apo «Kur pyesja nanën», «Motrës», etj. bie në sy dashuria dhe malli për atdheun, për të afërmit, ideja e motiveve patriotike dhe shoqërore. Për shumë vjersha të D. Siliqit kjo shkrirje është karakteristike. Ai i sheh fenomenet dhe njerëzit në prizmin shoqërorë dhe klasor. Elementet biografikë, varfëria e një familjeje qytetare para çlirimt, bëhen një shprehje tipike e fatit të popullit tonë në të kaluarën. Në fillim të shtatë fëmijët nën një jorgan, thotë poeti, rronin në varfëri, tanë kohët ndryshuan, po nëna nuk është më që të na shohë; mbuluan kasollet dhe çati i hodhën gjithë atdheut «Kur pyesja nënën» është e bukur, e thjeshtë dhe e ngrohtë, sepse frymëzimi merr hov ngajeta konkrete dhe janë gjetur hollësi prekëse dhe të natyrëshme. Kuptimi shoqëror del përmes së thjeshtës dhe së veçantës.

Përpjekja për të hyrë në shpirtin e njeriut tonë dhe për ta kuptuar jetën në koklavitjen e saj

ndihet në mjaft vjersha dhe në poemën «Këngë e re për dashurinë e vjetër» që ze një vend të rëndësishëm në këtë vëllim. Lufta nacionalçlirimtare ka qenë dhe mbetet një burim i madh temash dhe subjektesh për shkrimtarët tanë. Aspekte të ndryshme dhe probleme të veçanta të luftës bëhen sot objekt i artit sipas kërkesave të kohës, sipas synimeve tona për të njohur popullin dhe veprimtarinë e tij për të theksuar ide me vlerë aktuale. Anë të ndryshme të luftës, si edhe të aktualitetit kafen gjithash tu edhe sipas prirjeve individuale të autorëve, sipas dëshirave dhe mundësive të tyre. Kuptimplotë nga kjo pikpamje, është vjersha e bukur «Plaga», e cila bën fjalë për kushtet e vështira të mjekimit gjatë luftës, për solidaritetin shqëror, për humanizmin socialist që lindi bashkë me revolucionin tonë. Partizanja i jep ujë me duar një partizani të plagosur; nuk kanë asnje mjet për mjekim, këmisha e trupit shërbeu si fasho. Plaga shërohet, po vështrimi i syve të saj mbetet i pashuar për gjithë jetën. A nuk është kjo një ndjenjë e hollë psikologjike, një dashuri e fshehur, e pashfaqur tipike për kohën e luftës, që na prek edhe tan? Marrëdhëniet e njerëzve në luftë ishin shumë të pasura, të hijshme dhe arti nuk mund t'i thjeshtësojë apo t'i skematizojë ato, por duhet t'i japë në tërë harmoninë dhe kontrastin e ngjyrave.

Edhe në vjershat kushtuar aktualitetit, ndry-

shimeve shoqërore dhe morale të ditëve kur jetonte poeti, vihet re prirja realiste. Bie në sy gjithashtu një ndjenjë e singertë që krijon momentin kryesor të komunikimit të poezisë me lexuesin. Le të kujtojmë p.sh. vjersnën «Mësova atë ditë» mbi përshtypjet e poetit pas një vizite në malësinë e Matit. Të bie në sy dhe të prek realizmi i poezisë. Autori nuk mbyll sytë para realitetit, po thotë të vërtetën duke u nisur nga besimi i plotë se do të ndryshojë jeta dhe se përparimi arrihet me luftë.

M'habiti muejeta e malsorëve tonë, që ende mbajnë drurin nën krye, dhe fjalë ankimi nuk dijnë të të thonë, nuk dijnë me u lodhë e me u thyen.

Fshatarët i kanë gdhirë dy ditë e dy net për të ngritur digën n'afat; ata punëtorë, fshatarë — «mbajnë mbi shpinë Shqipninë». Dhe autor i thotë se si instiktivisht heq kravatën përvesh mëngët dhe fut në xhep bllok....., që nuk i duhet, sepse përshtypjet e jetës janë shumë të gjalla dhe të forta. Dhe nëse autokritika, në këtë vjershë mund të duket ekstreme po ta shohim me gjak-ftohtësi, ajo është e ndjerë, e singertë dhe e kuptueshme në kontekstin e poezisë. Është po ajo frymë e përbuzjes së intelektualizmit dhe e të qëndruarit larg jetës dhe popullit që gjemë edhe ndër poetë të tjerë si në vargjet e F. Arapit, D. Agollit, etj.

Në këtë vëllim bota e poetit na shfaqet në shumanshmërinë e saj. Personaliteti i D. Siliqit del i qartë edhe me ciklin për dashurinë. Ndjenja ndaj vajzës është e pastër, e përmbajtur, por e thellë. Ai nuk e zbulon menjëherë bukurinë shpirtërore të vajzës. Dashurinë ai e gjen në thellësi dhe jo në sipërsaqe. Puna, qëndrimi i njeriut, shpirti i sakrificës, gadishmëria për t'u ndihmuar njerëzve kudo që të jenë, i lidhin njerëzit me ndjenja të vërteta. Përveç thelbit moral, sipas botë-kuptimit socialist mbi marrëdhëniet në dashuri kemi të bëjmë edhe me veçantinë individuale të dashurisë së poetit, i cili tërhiqet nga bukuria e qetë, pa shkëlqim të jashtëm, nga ftohtësia e dukshme dhe lulëzimi i brendshëm që i ngjan luleborës, e cila ruan bukurinë e saj nën dëborë. Kjo është një veçanti, po vlera kryesore e këtij cikli qëndron te thelbi moral. Ndjenjat dhe mendimet që përshkojnë këto vjersha, frymëzimi që kanë dhe shkrirja e harmonishme në to e ndjenjës shoqërore dhe personale, janë një shembull i bukur për rininë e sotme, e cila duhet të njohë dhe ta mbajë mend punën dhe veprën e këtij njeriu që u rrit në revolucion dhe që e deshte aq shumë rininë.

Ndër krijimet më të mira të D. Siliqit, ku duket përparimi i tij si poet, prirja për t'u thelluar në botën shpirtërore të njeriut, për të shprehur ndryshimet shoqërore dhe psikologjike (prirje e përgjithshme për poezinë tonë të atyre viteve)

është poema «Këngë e re për dashurinë e vjetër». Këtu edhe mendimi, edhe vargu, edhe zhvillimi i subjektit, të përshtatshëm për poezinë, edhe detaji psikologjik e figurat e rralla, po të gjetura me vend dhe brenda stilit të veprës, të gjitha komponentet janë të një niveli të ngritur që shkon krahas zhvillimit të përgjithshëm të poezisë sonë më të mirë.

Kjo poemë është një novelë në vargje dhe dihet se sa e vështirë është kjo për poezinë.

Eshtë e vështirë edhe për ne sot, sepse si gjithnjë duhet bërë poezi e jo prozë, duhet ruajtur nga narracioni i vjetruar dhe monoton; sot duhet shprehur subjekti me një filosofi më të thellë dhe më të ngjeshur me faktet, që gjykimi i poetit të shkrihet më mirë, me vetë ngjarjen, nga pozitat socialiste, sipas metodës së realizmit socialist dhe jo në një mënyrë arkaike dhe të demoduar. Në përgjithësi D. Siliqi ia ka arritur qëllimit të vet në këtë vepër dhe ne ndjejmë një poet të ngrohët lirik, meditios me përgjithësimë dhe hove të bucura poetike, me kalime të goditura nga narracioni te parantezat lirike, nga përshkrimi i dridhjeve të brendshme shpirtërore, te momentet e qeta të një pasqyrimi objektiv. Dhe kështu fati i gruas shqiptare që priste gjithë jetën burrin e mërguar, me gjithë dëshpërimin dhe trimërinë për të mbajtur fëmijët, fati i atyre që iknin në dhe të huaj me brengë në zemër, këtu

nuk jepen (dhe s'mund të jepeshin) si një përsë-ritje e poezisë sonë të njohur mbi kurbetin, po në një sfond tjetër dhe nga një kënd tjetër vështrimi. Xheladini kthehet nga Amerika për një «varr në Progonat» për të ngrysur ditët e fundit të jetës, pojeta e thërret të hyjë në gjirin e saj. Lëvizjet shpirtërore në marrëdhëniet midis babaït të kthyer, të birit dhe të shoqes përshkruhen me vërtetësi dhe në mënyrë konçize në këtë poemë. Hetimi psikologjik është një meritë e rëndësishme e veprës, e cila mund të konsiderohet si një poemë tregimtare nga më të goditurat e poezisë sonç të re, në llojin liriko-psikologjike.

Duke mbyllur librin e D. Siliqit, ne sjellim në mend njeriun dhe poetin. Zemra e tij rrithet për Partinë dhe popullin, për të s'kishte gjë më të bukur dhe më të shtrenjtë se komunizmi.

Dalan Shapullo

PËRMBAJTJA

Parathënje ..... 3

*Luftë e punë*

Revolucioni .....	15
Ushtari yt do jem pérhera .....	16
Flamur i Partisë .....	19
Atdheu .....	21
Republikës (këngë) .....	23
Si molla të egra jemi rritë .....	24
Një ulli në breg të Jonit .....	25
Sa fort Shqipni .....	27
Kur pyesja nanën .....	30
Nana .....	31
Motrës .....	33
Prroni .....	35
Baresha .....	37
Pranvera erdhi, po s'lulëzoi .....	38
Plágë .....	40
Mbi Rozafën shekullore .....	42
Helmësi .....	44
Ligji i ri mbi Mat .....	46
Mësova atë ditë .....	48
Peshkatarët .....	50
Te vala e Drinit .....	51
Lahuta .....	56
Rranjët .....	58
Thethi .....	59
Shtëpia e re .....	60
Mirditorja .....	62